




QAA

Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri


**Raport i Vlerësimit Institucional i
Akademisë së Shkencave të Aplikuara,
REALD
Maj 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Znj. Beatrice Ollerenshaw Kryetare



2 Profesor John Baldock Anëtar



3 Dr. Alketa Grepcka Anëtare



Data: 29-30 maj 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raport i detajuar	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	12
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	23
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	26
Lista e dokumenteve	30

Rreth këtij vlerësimi

Ky vlerësim institucional ka për qëllim të përgjithshëm të kontrollojë dhe vlerësojë, për secilin prej IAL-ve, shkallën e përmbushjes së standardeve shtetërore shqiptare të cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi institucional i jashtëm është një proces këqyrje, kontrolli dhe vlerësimi nga ekspertë të jashtëm. Secili grup vlerësimi përbëhet nga ekspertë nga Mbretëria e Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA-UK), dhe ekspertë shqiptarë, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Publike Shqiptare e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-UK.

Raportet e përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, në bazë të shkallës që IAL-ja përmbush standardet, por edhe për informimin e IAL-ve, Qeverisë Shqiptare, publikut dhe studentëve mbi shkallën që IAL-ja përmbush standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojë çështjet me përparësi për tu përmirësuar (procesi përmes të cilit ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë sistematikisht cilësinë e shërbimit dhe mënyrat si ata i mbështetin studentët për të nxënë).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë fusha vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët e Mbështetja e tyre. Ky raport nxjerr në pah karakteristikat e praktikave të mira, jep rekomandime, konfirmon veprimet në proces dhe paraqet dobësitë për çdo fushë vlerësimi, së bashku me një gjykim se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush standardet. Ekspertët mund të japin këto gjykime: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk përmbushen.

Në fund, ekspertët dalim me një rekomandim, në formën e një gjykimi të përmbledhur, drejtuar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përmbledhur mund të jetë një shkallë e më poshtë:

- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë nuk janë përmbushur.**

Gjatë procesit të hartimit të raportit, QAA-UK ofroi ekspertizën e saj duke siguruar që grupi i ekspertëve të mbështesë konkluzionet e tij në evidenca. Gjithashtu ajo dha ndihmesën e saj duke redaktuar dhe hartuar përmbledhjen e raportit të plotë të dhënë më poshtë.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia e Shkencave të Aplikuara "Reald" (Akademia, ASAR) u themelua në vitin 2011 dhe grupi i parë i studentëve të saj u diplomua në fund të vitit 2015-16. Ajo është një organizatë private dhe, në bazë të legjislacionit të ri, ka statusin e Kolegjit Universitar. Ajo ndodhet në jug të Shqipërisë, në Vlorë. Misioni i saj është të ofrojë arsim të lartë për të mbështetur nevojat profesionale dhe të punës në rajon. ASAR-i ndodhet në një ndërtesë moderne në periferi të qytetit.

Ka dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore (me departamentet e Farmacisë, Infermierisë, Fizioterapisë dhe Stomatologjisë) dhe Fakulteti i Shkencave Humane ose Ekonomisë (me departamentet e Financës dhe Menaxhimit). Ka edhe një qendër kërkimore ndërsektoriale. Programet e ciklit të parë që kulmojnë me marrjen e diplomës Bachelor ofrohen për Menaxhim, Marketing, Fizioterapi dhe Infermieri e Përgjithshme, ndërsa programet Master ofrohen për Stomatologji dhe Farmaci. Këto janë programe pesëvjeçare që integrojnë studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Në vitin 2012, akademisë iu miratua ofrimi i një Masteri profesional në Menaxhim Infermieri. Të gjitha programet ofrohen me kohë të plotë, dhe nuk ka studim në distancë.

ASAR-i ka 218 studentë në programet trevjeçare universitare dhe 97 në programet pesëvjeçare të Masterit të integruar. Ka një rritje me 60 dhe 20 vetë përkatësisht në vitet 2014-15. Në vitin 2015-16, u diplomuan 115 studentë në programet trevjeçare dhe 58 në programet e Masterit të integruar. Ka 48 vetë staf akademik me kohë të plotë dhe 23 me kohë të pjesëshme, të cilët kanë të paktën një diplomë Master, ndërsa 19 prej tyre kanë doktorata. Ka një profesor dhe dy profesorë të asociuar. Shumica e studentëve dhe e stafit janë shqiptarë, por ka gjashtë studentë italianë dhe dy punonjës jo-shqiptarë.

Ka nëntë struktura administrative (Rektorati, Këshilli i Administrimit, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Zyra e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë, Kancelaria, biblioteka, arkivi dhe zyra e burimeve njerëzore) që mbështeten nga nëntë anëtarë të personelit administrativ dhe mbështetës.

Raport i përmbledhur

Raporti i vetëvlerësimit (RVV) për Akademinë e Shkencave të Aplikuara "Reald" (Akademia ASAR) u përgatit nga një ekip prej pesë personash, duke përfshirë një përfaqësues të studentëve. Projektraporti u diskutua në një takim të hapur. Studentët që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi kishin dijeni për RVV-në dhe përmbajtjen e tij. Ai është i shkruar qartë, pasqyron çështjet e kërkuara për fushat e vlerësimit dhe dokumentacioni i dhënë si evidencë referohet në tekst. Raporti përfundon me sugjerime për përmirësime, me anë të të cilave do të mundësohej një realizim më i plotë i standardeve. Këto sugjerime janë në përputhje me planin e zhvillimit të Akademisë dhe me mendimet e studentëve, në veçanti në lidhje me aksesin në godinë për personat me aftësi të kufizuara dhe rëndësinë e zgjerimit të mundësive për shkëmbimin dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit.

Vizita u zhvillua gjatë dy ditëve, më 29 dhe 30 maj 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë me përvojë në arsimin e lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga një institucion shqiptar. Agjencia Publike e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL) vuri në dispozicion, për të ndihmuar grupin e vlerësimit, Drejtuesin e Vlerësimit dhe një sekretar për të mbajtur shënime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori në shqyrtim RVV-në dhe dokumentacionin mbështetës të marrë tetë javë përpara vizitës së vlerësimit. Këto dokumente paraqisnin detaje mbi strukturat, politikat dhe procedurat mbi të cilat mbështetet veprimtaria akademike e ASAR-it dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i shqyrtoi ato duke i krahasuar me Standardet shtetërore të cilësisë në Shqipëri. Evidencat përfshinin statutin dhe rregulloret, përshkrimet e programit, të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve, raporte vjetore dhe planet e veprimit, si dhe modele të kontratave të punës të personelit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kishte gjithashtu akses në faqen e internetit.

Gjatë vizitës vlerësuese, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi mbledhje me drejtues të lartë, studentë, lektorë dhe personel administrativ e mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm e ortakë. Këto mbledhje bënë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të qartësojë procedurat, përgjegjësitë dhe këndvështrimet institucionale. Gjatë të gjitha mbledhjeve, u mbajtën procesverbale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri një vizitë në ASAR për të parë mjediset e mësimdhënies dhe mësimnxënies, veçanërisht laboratorët dhe klinikat e fizioterapisë dhe stomatologjisë ku anëtarë të komunitetit lokal mund të marrin trajtim pa pagesë nga studentët nën mbikëqyrje.

ASAR vepron në bazë të statutit të miratuar dhe ka një strukturë qeverisëse, duke përfshirë një Rektor, Zëvendësrektor dhe kancelar. Struktura e fakultetit menaxhohet nga dekani i fakultetit, i cili drejton këshillat e fakultetit dhe një strukturë komisionesh që përfshijnë Këshillin e Administrimit, Këshillin e Etikës dhe Senatin Akademik. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ku bën pjesë edhe një përfaqësues i studentëve, është një organ i pavarur. Ka një ndarje të qartë ndërmjet organeve vendimmarrëse financiare dhe akademike. Strategjia e zhvillimit dhe plani vjetor përmbajnë planet për zhvillimin të mëtejshëm të ASAR-it, në fusha si të nxënësve gjatë gjithë jetës, bashkëpunimet, zhvillimi i mjediseve të mësimdhënies dhe të nxënësve dhe angazhimi i studentëve në aktivitetet kërkimore.

Studentët janë të mirëpërfaqësuar në organet vendimmarrëse dhe stafi angazhohet plotësisht në diskutimin e planeve të ASAR-it. Senati Akademik, Këshillat e Fakultetit dhe NJSBC, të gjitha përfshijnë përfaqësues të studentëve. Ka edhe një Këshill Studentor mjaft aktiv. Mendimet e studentëve merren parasysh dhe, në përgjigje të shqetësimeve të tyre, bëhen ndryshime. ASAR-i ka bërë përmirësimin e laboratorëve dentarë dhe të farmacisë, menjëherë si reagim ndaj komenteve të studentëve dhe kërkesave të akreditimit. Studentët janë veçanërisht të shqetësuar se aksesin në godinën e ASAR-it është e vështirë për këdo që është me aftësi të kufizuara dhe e mbështesin fuqishëm këtë pikë veprimi të identifikuar në RVV.

Për përcaktimin, miratimin dhe monitorimin e buxhetit ndërmerret një proces i qartë, përmes Kancelarit dhe Këshillit të Administrimit. Stafi shtesë, pajisjet dhe veprimtaritë kërkimore mund të financohen mbi bazën e kërkesave formale, në përputhje me çështjet me përparësi për institucionin. Në klasa të ndryshme, numri i studentëve është rregulluar për të siguruar që madhësia e klasës të jetë në përputhje me burimet në dispozicion.

Për emërimin e stafit zbatohet një procedurë transparente duke përfshirë kolegët, në përgjigje të nevojave të mësimdhënies për vitin përkatës. Stafi me kohë të pjesshme është gjithashtu profesionist në fusha si farmaci dhe infermieri, dhe sjellin në mësimdhënie përvojën e tyre aktuale në çështjet

mjekësore, në mënyrë që studentët të kuptojnë rastet e vërteta dhe aktuale. Personeli mësimor vlerësohet nga NjSBC-ja, kryesisht në bazë të mendimit të studentëve. Drejtuesit e departamenteve raportojnë çdo vit për të konfirmuar sjelljen profesionale të stafit. Raporti vjetor i NjSBC-së përmban një analizë të pikave të forta e të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, si dhe një plan veprimi.

ASAR-i është i angazhuar të mbështesë nevojat e rajonit vendor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi dokumentacionin e studimit të tregut të punës dhe të veprimtarive të studentëve e stafit brenda zonës vendore, duke përfshirë edhe ofrimin e kontrolleve shëndetësore. Studentët kanë kryer punë vullnetare në komunitet për të mbështetur njerëzit në kohë nevojë, si për shembull pas përmytjeve, dhe kanë ofruar ndihmesë për një shtëpi fëmije vendore. Studentët përfitojnë nga mundësia për të kryer praktika pranë bizneseve dhe ofruesve vendorë të shërbimeve shëndetësore. Ata duket se kanë prirjen të përdorin aftësitë e tyre në dobi të zonës vendore, pasi të diplomohen, si për shembull duke hapur farmaci në zonat rurale që nuk ka të tilla. ASAR-i synon të përforcojë disa bashkëpunime për të rritur mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët. Akademia është angazhuar në disa projekte në kuadër të programit Erasmus, dhe po diskutohen edhe më shumë projekte.

Vetëm një brez studentësh është diplomuar deri tani dhe ASAR-i ka marrë hapa aktivë për të mbledhur dhe ruajtur të dhënat e punësimit të tyre, duke mbajtur kontakte të drejtpërdrejta me ish-studentët dhe me punëdhënësit në rajon. Punëdhënësit me të cilët u Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi një mbledhje, i respektojnë studentët e ASAR-it dhe kanë mendim shumë pozitiv për kontributin që ata mund të japin në fushën e shëndetësisë dhe biznesit. Në zonën e Vlorës, turizmi është i rëndësishëm dhe hotelet do të përfitojnë nga menaxherët e trajnuar në biznes dhe marketing. Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZKK) është duke zhvilluar një bazë të dhënash për punësimin e të diplomuarve dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi një raport që analizonte informacionet e deritanishme sipas moshës dhe gjinisë. ZKK mbështet studentët të aplikojnë për punë duke i këshilluar për përgatitjen e CV-ve dhe në mënyrën si duhet të sillen në një intervistë.

Rregulloret e programeve dhe të moduleve përcaktojnë qartë kurrikulën, duke përcaktuar edhe kriteret e pranimit dhe vlerësimin. Në fillim të vitit, studentët marrin informacion rreth studimeve të tyre të ardhshme dhe janë të bindur se kanë kuptuar se çfarë do të kërkohet prej tyre. Ata kanë mundësi të marrin ndihmë nga tutorët, nëse do të jetë e nevojshme. ASAR-i synon të japë mësim në mënyrë aktive dhe studentët e vlerësojnë si shumë të mirë marrëdhënien që kanë me stafin. Burimet e bibliotekës janë një fushë në zhvillim për ASAR-in, veçanërisht puna për të krijuar një katalog online dhe vënia në dispozicion e burimeve elektronike të një standardi të mirë në mënyrë më të thjeshtë. ASAR-i është duke negociuar me McGraw-Hill për një licencë të përshtatshme. Studentët marrin një shtojcë diplome në gjuhën shqipe dhe angleze në momentin e diplomimit.

ASAR-i është i angazhuar të integrojë kërkimin në mësimdhënie përmes veprimtarive të Qendrës Kërkimore Shkencore, e cila synon gjithashtu të zhvillojë kërkime në përputhje me nevojat e rajonit. Kërkimet bëhen në bazë të marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit. Stafi merr pjesë në konferenca dhe publikon punime. Janë kryer disa kërkime në bashkëpunim me biznesin dhe ASAR-i po punon me autoritetet rajonale për të aplikuar për fonde kërkimore sipas skemës Interreg Erasmus. Aktiviteti kërkimor publikohet në një buletin të rregullt. Stafi nxitet të kryejë doktorata dhe oraret e mësimdhënies janë përshtatur sipas studimeve të tyre të doktoratës. Përgjegjësi i Departamentit përfshin në raportin e tij vjetor veprimtarinë e kërkimit.

Gjatë vlerësimit dhe arritjes së gjykimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një fushë (ofrimi i burimeve të bibliotekës online) që Universiteti ka pranuar se ka nevojë të zhvillohet më tej dhe pohoi veprimin e propozuar nga ana e Universitetit. Për të siguruar më tej përputhshmërinë me Standardet Shtetërore të Cilësisë, ASAR-i duhet të marrë në shqyrtim rekomandimin e grupit të vlerësimit (në lidhje me aksesin për personat me aftësi të kufizuara). Grupi identifikoi dy fusha të praktikës së mirë: bashkëpunimet e ASAR-it që mbështesin studentët të fitojnë përvojë të nxëni dhe kontributin e ASAR-it në rajon, dhe efektshmëria e Këshillit Studentor.

ASAR-i e kreu procesin e vlerësimit në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dëshiron të theksojë angazhimin tejet pozitiv të ASAR-it në këtë proces, natyrën vlerësuese të RVV-së dhe bashkëpunimin që iu dha grupit të vlerësimit. Këtu përfshihet dhënia e informacionit shtesë, shumë shpejt, kur kërkohet, dhe mbështetja gjatë mbledhjeve me përkthyes.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm del në përfundimin se standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur plotësisht në katër fusha dhe kryesisht në një fushë. Si rezultat, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm del në përfundimin se standardet janë përmbushur plotësisht në tërësi. Duke marrë parasysh faktin që ASAR-i ka reaguar shpejt dhe në mënyrë pozitive ndaj sugjerimeve të mëparshme të dhëna nga studentët dhe ekipet e akreditimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i bindur se ASAR-i do të veprojë shpejt dhe në mënyrë efikase duke zbatuar pohimin dhe rekomandimin e dhënë. Prandaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shprehet se gjykimi i përgjithshëm është që standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet me një varg punëdhënësish dhe organizatash, të cilat ofrojnë mundësi që studentët të fitojnë përvojë në vendin e punës, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe rrisin mundësitë e punësimit të tyre, gjë që mbështet gjithashtu kontributin e Akademisë Reale në rajon (pikat 1.10, 1.11, 2.14, 3.9; **Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3, Kapitulli III Standardi VII.6, Kapitulli I Standardi I.9**)
- efektshmëria i Këshillit Studentor, si dhe angazhimi i akademisë ndaj veprimtarive që rrisin mirëqenien e banorëve të zonës (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- godina nuk është e sigurt për studentët dhe vizitorët me aftësi të kufizuara, veçanërisht ato me vështirësi në lëvizje (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- godina të bëhet e sigurt dhe miqësore për t'u përdorur nga studentë dhe vizitorë me aftësi të kufizuara, duke shtuar binarë udhëzues në hyrje të godinës dhe në shkallë, si dhe të ndërtohet një rampë në hyrje, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- ASAR-i duhet të përfundojë zhvillimin e një katalogu bibliotekar online dhe të zbatojë marrëveshjen me McGraw-Hill për akses në libra elektronike (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përbushur plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit që Akademia Reale i **përbush plotësisht** standardet shtetërore të cilësisë.

Raport i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Akademia e Studimeve të Aplikuara “Reald” përbëhet nga dy njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Ekonomisë ose Shkencave Humane. Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbëhet nga departamentet e Infermierisë / Stomatologjisë, Farmacisë dhe Fizioterapisë. Fakulteti i Ekonomisë përfshin departamentet e Financës, Menaxhimit dhe Marketingut. Raporti i vetëvlerësimit (RVV) **[RVV fq.6]** përshkruan kuadrin drejtues dhe rregullator të ASAR-it, të hartuar në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. ASAR-i vepron në përputhje me kërkesat e Statutit të tij, **[1]** të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi **[ligji nr. 80/2015 2 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionin e Arsimit të Lartë”]** dhe që përcaktojnë misionin dhe objektivat kryesore të Akademisë **[1 neni 3]**. Misioni dhe vizioni i ASAR-it pasqyrohet në hartimin e programeve, procesin mësimor dhe zhvillimin e kurrikulave. Statuti i ASAR-it është në përputhje me misionin e institucionit, i përshtatur në varësi të faktorëve të jashtëm. Senati Akademik i ASAR-it ka miratuar një Statut të rishikuar që pasqyron statusin e tij të ri si Kolegj Universitar **[52; 84]**. Ky ndryshim pasqyron zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit të Vlorës dhe RVV-ja deklaron se do të rrisë qëndrueshmërinë e ASAR-it duke mbështetur kontributin e tij në këtë zonë **[RVV fq.6]**. Senati akademik ka miratuar një Rregullore të brendshme në përputhje me Statutin **[2]**. Mbi bazën e rregulloreve institucionale, secili prej fakulteteve ka rregulloren e vet **[3, 7]**. **[Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 ASAR-i ka organe kolegjiale, struktura organizative dhe autoritete qeverisëse që mbështesin veprimtarinë e tij akademike **[41]**. Senati akademik është organi më i lartë vendimmarrës, i cili funksionon në bazë të një rregulloreje të përcaktuar qartë **[1 neni 15; 4; 11]**. Sfera e veprimtarisë së Këshillit të Administrimit është e përcaktuar qartë në statutin e ASAR-it **[1 Neni 10]**: të diskutojë dhe miratojë çështjet financiare dhe funksionet bazë të një rregulloreje **[13]**. Këshilli i Fakultetit është një organ kolegjial vendimmarrës në nivel fakulteti. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë, të zgjedhur çdo katër vjet **[1 neni 20]**. Pjesë përbërëse e strukturës së ASAR-it është edhe Rektorati, i përcaktuar në Statut, i cili zbaton vendimet e marra nga Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit **[1 neni 12]**. Këshilli i Etikës është një organ kolegjial i sanksionuar në statut **[1 neni 16]**, i cili funksionon në bazë të një vendimi të Senatit Akademik **[5]**. Rregulloret ekzistuese për drejtimin dhe administrimin e ASAR-it dhe për vendimmarrjen kolegjiale, funksionojnë rregullisht dhe janë të mirëkuptuara nga stafi në të gjitha nivelet **[M1, M8]**. Stafi akademik merr dijeni për vendimet që merr Këshilli i Administrimit ose Senati Akademik. Njoftimet kalojnë përmes Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit ose me anë të postës elektronike **[M8 fq.1]**. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) punon me Rektoratin dhe parashikohet në Statut si organi përgjegjës për vlerësimin periodik të procesit mësimor dhe veprimtarive kërkimore **[1 neni 17]**. **[Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Rregulloret ekzistuese për drejtimin dhe administrimin e ASAR-it dhe për vendimmarrjen kolegjiale, funksionojnë rregullisht dhe janë të mirëkuptuara nga stafi në të gjitha nivelet **[M1, M8]**. Siç tregohet në paragrafin 1.2, stafi akademik merr dijeni mbi vendimet që merr Këshilli i Administrimit ose Senati Akademik nga Dekani ose Përgjegjësi i Departamentit, në mbledhje ose përmes postës elektronike **[M8 fq.1]**. **[Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 ASAR-i siguron respektimin e kufijve të autonomisë së tij dhe ushtron autonominë e vet brenda kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Vetëqeverisja në çështjet institucionale shtrihet në të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative, në veprimtaritë

mësimore dhe shkencore, në çështjet financiare dhe administrative dhe në miratimin e marrëveshjeve institucionale me institucione të jashtme [M1 q2]. Njësia e pavarur për auditimin e brendshëm të pasqyrave financiare, A&E Auditing Sh.fq.k, siguron në mënyrë efikase që ASAR-i të jetë në përputhje me statutin dhe rregulloret e brendshme, si dhe me ligjin kombëtar për arsimin e lartë [8]. ASAR-i ka qenë objekt i procesit të akreditimi të drejtuar nga ekspertë brenda dhe jashtë Shqipërisë [RVV fq. 9; 43; 44]. Baza e të ardhurave të ASAR-it është pagesa e studentëve, por ka edhe partnerë, projekte dhe bashkëpunime me universitetet e huaja. Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik është çështje qendrore për t'u zhvilluar për organet administrative dhe vendimmarrëse të Akademisë [M3; M4; M7]. [Kapitulli III Standardi I.4]

- 1.5 Strategjia 2011-16 është hartuar në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e ASAR-it dhe përmban objektiva të përshtatshme dhe veprime mbështetëse për tu zbatuar [9]. Kjo strategji bëri që Akademia të përmbushte disa objektiva, siç janë ofrimi i programeve të integruara të Masterit, promovimi i trajnimeve profesionale dhe bashkëpunimi me shoqëri të tjera private vendore, me Bashkinë e Vlorës dhe me universitete [59; M2; M5; M7]. Strategjia e re 2016-21 [10; 84] synon të arrijë zhvillimin e programeve të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të vendit, veçanërisht ato të rajonit jugor. Ndryshimet e ligjit të ri janë pasqyruar në strategjinë e re, duke përfshirë një vendim të fundit të Qeverisë i cili lejon ASAR-in të ofrojë edukim të vazhdueshëm, një mundësi kjo që nuk ishte paparashikuar në strategjinë e mëparshme [M1]. [Kapitulli III Standardi I.5]
- 1.6 Në fund të çdo viti akademik, Rektorati përgatit raportin vjetor dhe e paraqet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (MAS). Ai paraqet një pasqyrim të përgjithshëm të veprimtarive arsimore dhe shkencore të brendshme dhe të jashtme dhe bazohet në një poqes vetëvlerësimi të zgjeruar, proces për të cilin stafi ka dijeni [RVV fq. 11; 25; 57; 58; 64; 80; 91]. Raporti merr për informacion bazë raportin vjetor të NjSBC-së, i hartuar mbi bazën e mendimeve të studentëve, dhe raportet e departamenteve mbi veprimtaritë e mësimdhënies të përfunduara në fund të vitit akademik dhe mbi veprimtarinë kërkimore të finalizuar në fund të vitit kalendarik [RVV faqe 11; M1 fq.6]. Raporti vjetor i NjSBC-së bëhet sipas analizës SWOT dhe një plan veprimi shoqëruar, të gjitha të miratuara nga Senati Akademik [57]. [Kapitulli III Standardi I.6]
- 1.7 Veprimtaria akademike e shkencore e ASAR-it zhvillohet në dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, me katër departamente (Fizioterapi, Farmaci, Infermieri dhe Stomatologji) dhe Fakulteti i Ekonomisë ose Shkencave Humane, me dy departamente (Financë dhe Menaxhim) [RVV fq. 12; 11; M2; M6; M7]. Për më tepër, Qendra e Kërkimit Shkencor koordinon punën kërkimore duke respektuar lirinë e secilit departament; identifikon përparësitë kyçe në lidhje me objektivat strategjike dhe nevojat rajonale për zhvillim [M1]. Fakultetet dhe departamentet organizohen në përputhje me kërkesat ligjore; strukturat e drejtimit, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike. Njësitë organizative dhe stafi akademik i njësive bazë është i kualifikuar siç duhet [M2]. ASAR-i ushtron lirinë e tij akademike në mësimdhënie dhe kërkime. Stafi mund të ushtrojë pavarësinë e tij në organizimin e aktiviteteve akademike në mësimdhënie, kërkime dhe kurrikulën e programeve studimore [M2; M6]. ASAR-i ofron shtatë programe studimi, nga të cilat katër janë të ciklit të parë (niveli Bachelor), një është cikli i dytë (Master profesional) dhe dy programe të integruara Master të Shkencave të ciklit të dytë [RVV fq. 12; 11; M2; M6]. ASAR-i ka faqen e tij zyrtare www.asar.edu.al, e cila përditësohet rregullisht [M7]. [Kapitulli III Standardi II.1]
- 1.8 ASAR-i siguron diskutim konstruktiv në të gjitha organet e tij vendimmarrëse dhe administrative [M1; M2; M6]. Stafi akademik dhe studentët kanë përfaqësuesit e tyre në organet kryesore [M2; M3; M4] në mënyrë që të jenë gjithmonë të përfshirë në

diskutime dhe të jenë pjesë e procesit të vendimmarrjes. Proceset e vendimmarrjes janë gjithëpërfshirëse. Diskutimet zhvillohen në departament dhe më pas në Këshillin e Fakultetit, i cili kryesohet nga Dekani i Fakultetit. Mendimet e Këshillit i kalojnë Senatit Akademik ose Këshillit të Administrimit për shqyrtim [32; M1; M6]. Studentët janë gjithashtu anëtarë aktivë të bordeve dhe këshillave dhe paraqesin në këto organe vendimmarrëse shqetësimet dhe mendimet e studentëve, si p.sh. mendimet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe, në veçanti, komentet që mund të mos jenë ngritur në asnjë vend tjetër [M3; 4]. Vendimet për transferimin e studentëve ose aplikimet diskutohen mes stafit akademik. Ata janë gjithashtu pjesë e miratimit të buxhetit dhe proceseve të rekrutimit të stafit [M2; 6]. [Kapitulli III Standardi II.3]

- 1.9 Në lidhje me punësimin, pranimin, pagesën dhe përdorimin e informacionit publik, ASAR-i duket se respekton dhe vepron në përputhje me rregullat kryesore për konkurrencën. [RVV fq. 12; 9; 10 pika 1; M1; M2; M6] ASAR-i mbledh informacion rregullisht për çështjet me përparësi zhvillimi ekonomik rajonal. [58] Si shembuj mund të përmendim lidhjen me Drejtorinë Rajonale të Bashkisë së Vlorës, mbledhjen e të dhënave statistikore nga INSTAT-i dhe marrjen e informacionit nga partnerët, ndërkohë që studentët bëjnë praktika. Plani i ri Strategjik i Zhvillimit 2016-2021 thekson gjithashtu rëndësinë e trajtimit të nevojave të tregut të punës [10, fq. 5 pika d]. Në mbështetje të kësaj është kryer një studim tregu nga ana e Departamentit të Menaxhimit [58]. Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZKK) mbledh të dhëna statistikore dhe të tjera nga Zyra e Punës dhe INSTAT-i në lidhje me çështjet me përparësi zhvillimi rajonal dhe mbi vendet e lira të punës në zonën e Vlorës [26]. Përmes procesit të praktikave mblidhet informacion në lidhje me nevojat e shoqërive, i cili përbën bazën e zhvillimit të kurrikulës [60; M6; M7]. [Kapitulli III Standardi III.1]
- 1.10 ASAR-i bashkëpunon me sukses me një sërë organizatash qeveritare dhe joqeveritare, shpesh përmes marrëveshjeve me shkrim [RVV fq. 13; 60; M6; M3; M4; M7; 10 fq.4]. Ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë Universitetin e Salernos në Itali, Institutin Politeknik të Leirisë në Portugali dhe Universitetin e Mjekësisë të Tiranës [2; 13; 60; 14]. Programet e studimit kanë pësuar ndryshime si pasojë e lidhjeve të bashkëpunimit dhe partneriteteve [M7]. Studentët përfitojnë nga bashkëpunimet rajonale të ASAR-it përmes lidhjeve me tregun e punës, të cilat përmirësojnë cilësinë e kurrikulës dhe mundësitë e punësimit të studentëve, dhe jo vetëm përmes praktikave të tyre. Bashkëpunimet në nivel ndërkombëtar ofrojnë gjithashtu mundësi për më shumë mobilitet të stafit dhe bashkëpunim për kërkime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e çmon si praktikë të mirë bashkëpunimet me një varg punëdhënësish dhe organizatash, të cilat ofrojnë mundësi që studentët të fitojnë përvojë në vendin e punës, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre, gjë që mbështet gjithashtu kontributin e Akademisë Reale në rajon (shiko gjithashtu pikat 1.11, 2.14 dhe 3.9) [Kapitulli III Standardi III.2]
- 1.11 Forca kryesore e bashkëpunimit të ASAR-it me institucione të jashtme është ofrimi i mundësive të studimit praktik. [60; M3; M4; M6; M7] Takimet me studentë dhe partnerët e jashtëm konfirmuan se studentët kanë mundësi të përfitojnë nga një varg lidhjesh të tilla me punëdhënësit vendorë dhe rajonalë publikë e privatë dhe se këto organizata ofrojnë këto mundësi që studentët të fitojnë përvojë praktike profesionale. Kjo gjë është karakteristike e praktikës së mirë të identifikuar në paragrafin 1.10. [M3; M4; M6]. [Kapitulli III Standardi III.3]
- 1.12 Stafi ndërkombëtar dhe mobiliteti i studentëve është një nga objektivat strategjike të ASAR-it, [RVV fq. 12; 10 pika 5] i cili ka organizuar konferenca dhe aktivitete shkencore me pjesëmarrës kombëtarë dhe ndërkombëtarë në mbështetje të këtij synimi. Si shembuj mund të përmendim: konferenca ndërdisiplinore ndërkombëtare

“Identiteti, imazhi dhe shoqëria gjatë në kohën e integritit dhe globalizimit” (2012) në bashkëpunim me Universitetin Ismail Qemali Vlorë, Universitetin Pavarësia, Vlorë dhe Universitetin Marin Barleti, Tiranë; konferenca mbi shkencën në ndihmë të komunitetin në vitin 2012; konferenca e parë e studimeve të stomatologjisë (2013); projekti ndërkombëtar, destinacionet e avancuara turistike (2014); projekti ndërkombëtar kërkimor për turizmin, Tulla e Babelit (2015); dhe konferenca mbi politikën fiskale dhe deklarin tatimor (2016) [15; M7]. ASAR-i luan një rol aktiv në mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe ofron mbështetje financiare për kërkimin akademik individual të ndërmarrë nga stafi akademik [M7; 88]. ASAR-i vuri në dispozicion evidenca të artikujve të botuar nga stafi akademik [69; M7]. Gjithashtu, ASAR-i mbështet lëvizjen e studentëve [RVV fq.14]. Ai fton profesorë të huaj të japin leksione të hapura dhe të ftuarit vijnë nga jashtë për të marrë pjesë në konferencat që organizohen, pavarësisht se evidencat e vëna në dispozicion nuk tregojnë qartë vitin e pjesëmarrjes së tyre apo ndikimin që ata kanë pasur në kërkimin shkencor [63].

[Kapitulli III Standardi III.4]

1.13 ASAR-i vepron në përputhje me kërkesat e Statutit të tij dhe rregullores së përgjithshme të brendshme dhe është i organizuar në mënyrë që siguron efektshmërinë e drejtimit dhe administrimit të tij. Vendimmarrja kolegjiale funksionon rregullisht dhe vendimet i komunikohen stafit në të gjitha nivelet. ASAR-i përdor në mënyrë efikase raportet dhe të dhënat në lidhje me çështjet e cilësisë, përfshirë informacionet dhe komentet e marra përmes anketimit të studentëve. Po ashtu, për t'i siguruar stafit akademik marrjen e reagimeve mbi veprimet e kryera, ASAR-i ka mekanizma formalë që zbatohen nga Zyra e Rektoratit ose Senati Akademik, duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga analiza e të dhënave të raporteve ose anketave. ASAR-i mbështet diskutimin dhe debatin në organet kolegjiale. Bordet dhe këshillat mbledhen rregullisht dhe rendi i ditës bëhet i ditur paraprakisht. ASAR-i siguron respektimin e kufijve të autonomisë së tij dhe e ushtron autonominë e vet brenda kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Të gjitha njësitë organizative akademike dhe administrative përfshihen në diskutimin e çështjeve mësimore, financiare dhe administrative. Stafi akademik ka pavarësinë që duhet për të organizuar aktivitetet akademike të mësimdhënies, kërkimit dhe zhvillimit të kurrikulës. ASAR-i luan një rol aktiv në studimit të tregut të punës dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZKK) ka një rol kyç në këtë drejtim. Studentët, të diplomuarit dhe punëdhënësit vlerësojnë punën e ZKK-së, duke përfshirë mënyrën si ajo ndjekin vendndodhjen e të diplomuarve dhe mirëmban komunikimin me punëdhënësit lokalë e rajonalë dhe partnerë të tjerë. Shtrirja dhe ndikimi i bashkëpunimeve të ASAR-it, në veçanti brenda rajonit, është një praktikë e mirë.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet me një varg punëdhënësish dhe organizatash, të cilat ofrojnë mundësi që studentët të fitojnë përvojë në vendin e punës, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe rrisin mundësitë e punësimit të tyre, gjë që mbështet gjithashtu kontributin e Akademisë Reale në rajon (pikat 1.10, 1.11, 2.14, 3.9; **Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi VII.6; Kapitulli I Standardi I.9**).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

Gjykimi

Standardet për organizimin dhe menaxhimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 ASAR-i ka një strategji për menaxhimin e cilësisë së mësimdhënies, e cila përfshin rritjen e numrit të personelit dhe trajnimin e tyre në përputhje me rritjen e numrit të studentëve si rezultat i ndryshimeve të rëndësishme në kërkesën e tregut **[M1]**. ASAR-i ndjek një politikë të qartë për rekrutimin e stafit akademik (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme). E drejta për të zgjedhur stafin rrjedh nga autonomia e Akademisë **[1 neni 18 dhe 19]** dhe kërkesat për rekrutim vijnë nga departamenti, si njësi themelore e menaxhimit **[M2]**. Kërkesat për stafin akademik me kohë të pjesëshme mund të trajtojnë mungesat e përkohshme të stafit, kur ata studiojnë për një doktoratë ose marrin pjesë në një projekt kërkimi, apo për arsye të tjera. Propozimi i departamentit kalon për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit dhe pastaj në Senatin Akademik. Kërkesat e rekrutimit të personelit paraqiten përpara fillimit të vitit akademik **[M8]**. Procedura e rekrutimit është e qartë dhe përbërja e komitetit të posaçëm është në përputhje me rregulloret e ASAR-it **[M8]**. Komiteti i posaçëm përbëhet nga katër anëtarë (kryetari dhe tre anëtarë) **[17]**. Në vlerësimin e aplikimeve, iu jepet përparësi kandidatëve që janë diplomuar në shkolla të mirënjohura jashtë vendit. Komiteti i posaçëm bën procesin e vlerësimit, ndërsa Rektori merr miratimin përfundimtar **[17]**. ASAR-i gjithashtu mirëpret stafin nga vende të tjera për konferenca dhe aktivitete të projektit **[63]**. **[Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 ASAR-i ndjek një politikë të qartë për të integruar stafin akademik në organet vendimmarrëse, duke pasqyruar statutin dhe rregulloret e tij të brendshme **[1; 2; 3; 4; 5; 6; 7; 9; 10; 11; 12]**. ASAR-i ofron ambiente laboratorike dhe mësimore, sipas kërkesave të stafit akademik **[M2; turi në terren]**. Gjithashtu, ka politika që sigurojnë që stafi akademik të ketë ose të marrë kualifikimin e duhur. Stafi ka marrë pjesë në një projekt të mbështetur nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe në konferenca ndërkombëtare **[M8; 62]**. Stafi i sapo rekrutuar mbështetet nga kolegë akademikë me më shumë përvojë **[M8]** dhe Qendra e Kërkimit luan një rol në zhvillimin e aftësive të tyre. Qëllimi i Qendrës është të koordinojë veprimtarinë kërkimore në të gjithë Akademinë dhe në çdo departament. Qendra e Kërkimit Shkencor bashkëpunon me departamentet për të përcaktuar çështjet me përparësi shkencore, të cilat lidhen ngushtë me objektivat strategjike të diktuar nga nevojat e zhvillimit rajonal **[M8]**. Çdo vit, departamentet i paraqesin Qendrës së Kërkimit Shkencor projektpropozime, i cili më pas, në bazë të çështjeve me përparësi kërkimi të pranuar, përzgjedh projektet më të mira dhe i kalon ato për miratim tek Senati Akademik dhe për mbështetje financiare tek Këshilli i Administrimit **[M2]**. Arritjet publikohen në buletin e ASAR-it dy herë në vit **[M2; M8]**. Stafi akademik përfshihet edhe në procesin e informimit të studentëve të ardhshëm rreth mundësive në ASAR **[M3; M4, M8]**. **[Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 ASAR-i ndjek një plan trajnimi në përputhje me çështjet me përparësi shkencore të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit **[9; 10]**. Stafi mund të marrë kualifikime dhe të zhvillojë aftësi të specializuara brenda kuadrit të bashkëpunimit me universitete në Shqipëri dhe jashtë saj, dhe ASAR-i siguron mbështetje financiare për këtë gjë **[92]**. Përfituesit kryesorë janë stafi që ndjek studimet e Doktoraturës **[M8]**. ASAR-i ka organizuar gjithashtu seminare dhe konferenca ndërkombëtare, si konferenca ndërkombëtare e vitit 2012, konferenca për “Shkencën në ndihmë të komunitetit” në vitin 2015, konferenca e parë e stomatologjisë në vitin 2015 dhe një konferencë mbi politikën fiskale dhe tatimin në vitin 2016. Ecuria e kërkimit monitorohet nga Qendra e Kërkimit Shkencor, ndërsa në nivel departamenti monitorohet përmes një procesi të udhëhequr nga përgjegjësi i departamentit. Ajo diskutohet dhe miratohet në Senat. Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik bëhet nga NjSBC-ja me anë të pyetësorëve që plotësohen nga studentët **[35; 36; 70; 71]**. Personeli i ri inkurajohet në procesin mësimor. Staf me më shumë përvojë dhe i lartë drejton, mbështet dhe

monitoron aktivitetin e tij mësimor **[M8]**. ASAR-i gjithashtu nxit mësuesit e huaj të bashkëveprojnë me stafin akademik dhe studentët **[63]**. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**

- 2.4 ASAR-i mbështet jetën institucionale shoqërore përmes aktiviteteve promovuese, ceremonive të diplomimit, promovimit të turizmit në Vlorë dhe ditëve të kushtuara për çështje të veçanta shëndetësore si HIV-AIDS dhe hipertensioni **[M3; M4; M7; M8]**. ASAR-i rrit ndërveprimin social të stafit akademik, administrativ dhe studentëve duke organizuar aktivitete pas orës së mësimit dhe ekskursionet **[RVV fq.18; 18; 68; 98]**. **[Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.5 ASAR-i merr seriozisht përgjegjësitë e tij në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Funkcionet e menaxhimit janë përcaktuar në statutin dhe rregulloren e brendshme të fakulteteve dhe njësive themelore, përkatësisht departamentet **[1 neni 35]**. Njësia administrative përfshin zyrën e burimeve njerëzore, e cila menaxhon procesin e rekrutimit, përgatitjen e kontratave të stafit akademik me kohë të plotë e të pjesshme dhe punësimin e stafit ndihmës e administrativ, në përputhje me Kodin Kombëtar të Punës. Të gjithë personat e emëruarit kanë një përkrahje pune **[31; 32]**. **[Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.6 ASAR-i është një institucion privat dhe baza e të ardhurave të tij është pagesa e studentëve, shoqëria themeluese, Eskeld sh.p.k, si dhe projekte me partnerë të ndryshëm **[1; 73]**. ASAR-i ka një strukturë të qartë formale për hartimin e buxhetit. Njësia administrative përgjegjëse për këtë gjë është zyra e financës. Kancelaria ka përgjegjësinë e përgjithshme për përcaktimin e projektbuxhetit **[1; 41]** në bashkëpunim me departamentet që janë pjesë e diskutimit **[M2; M8]**. Në nivel institucional, Këshilli i Fakultetit, Senati dhe Këshilli i Administrimit luajnë një rol vendimtar në diskutimin dhe miratimin e projektbuxhetit. Shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të përparësive financiare dhe nevojave të departamenteve **[M2]**. Për shembull, Fakulteti i Mjekësisë merr në shumë fonde si pasojë e pajisjeve laboratorike të shtrenjta që nevojiten. Rektorati është përgjegjës për zbatimin e vendimeve financiare. Buxheti parashikon gjithashtu mbështetje financiare për aktivitetet e studentëve, të cilat menaxhohen me përkrahje e ZKK-së **[vendimi i Këshillit të Administrimit për studentët; M7]**. **[Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.7 Në përputhje me Statutin e Akademisë dhe rregulloret e brendshme, Këshilli i Administrimit është organ vendimmarrës i ASAR-it, i cili mbikëqyr dhe kontrollon menaxhimin administrativ, financiar dhe ekonomik të aseteve dhe pasurisë së tij **[RVV fq. 19; 1 neni 11 pika d]**. Kancelari është përgjegjës për zbatimin e politikave financiare, administrimin e përditshëm dhe menaxhimin financiar të Akademisë. **[1; M2]** Kancelari ndihmohet në zbatimin dhe kontrollin e buxhetit nga një shoqëri e auditimit të jashtëm. Legjislacioni përcakton qartë proceset e auditimit. ASAR-i bën analizën financiare të të ardhurave nga tarifat e studentëve, dhe të shpenzimeve të nevojshme, duke përfshirë kërkesat e stafit për blerjen e pajisjeve të reja, artikujt e nevojshëm për kurset laboratorike, librat e bibliotekës dhe materialet kërkimore. Në bazë të kësaj analize, hartohet buxheti për vitin e ardhshëm **[RVV fq. 19; M7]**. **[Kapitulli III Standardi VI.2]**
- 2.8 ASAR-i është objekt i auditimit të brendshëm nga subjekti themelues, i auditimit të jashtëm dhe Drejtorisë Rajonale të Taksave, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kontrollit nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Procesi i auditimit ka një bazë të qartë ligjore për kryerjen e tij **[1]**. Proceset e monitorimit bëjnë të mundur identifikimin e problemeve në fakultet dhe hartimin e një plani veprimi për t'i trajtuar këto probleme **[Analiza SWOT]**. **[Kapitulli III Standardi VI.3]**

- 2.9 Sistemi i informacionit të ASAR-it koordinohet si me anë të një sistemi informacioni elektronik ashtu edhe me kopje fizike. Faqja e internetit përditësohet me informacionet më të reja dhe të rëndësishme për studentët ose grupet e tjera të interesit. Sistemi në linjë përbëhet nga një faqe interneti <http://asar.edu.al>, portali i stafit dhe studentit, rrjeti social, sistemi i medias dhe një sistem poste elektronike për studentët dhe stafin në domainin emër.mbiemër@asar.edu.al). Informacioni kryesor jepet edhe në tabelat e njoftimit të vendosura në çdo kat. Ka edhe një laborator TI-je. Broshurat dhe fletëpalosjet ofrojnë informacion në lidhje me programet e studimit. ASAR përdor reklamat në media dhe stacionin e televizionit lokal për të komunikuar aktivitetet dhe informacionin kryesor me partnerët dhe publikun **[RVV fq.20; 46; turi në terren; M6; M3; M4; M8]. [Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.10 Infrastruktura e teknologjisë së informacionit të ASAR-it përmban laboratorë kompjuterikë: 80 kompjuterë dhe 10 video projektorë që iu ofrojnë studentëve një mjedis studimi të rehatshëm dhe gjithëpërfshirës. ASAR-i ofron laboratorë mësimdhënie për lëndët mjekësore. Përveç kompjuterëve, printerëve dhe skanerëve, studentët kanë qasje në një gamë pajisjesh të specializuara, duke përfshirë “koka manekini” dhe ulëse për klinikë dentare, tavolina masazhi dhe një makinë Magnotech për fizioterapi **[75; RVV fq.21]**. Studentët përdorin kopje fizike dhe burime të bibliotekës në linjë [\[http://www.asar.edu.al/biblioteka-online\]](http://www.asar.edu.al/biblioteka-online). Akademia po negocion një marrëveshje me McGraw-Hill për të pasuruar aksesin në literaturën online (shiko paragrafin 5.5) **[M8]**. ASAR-i është e pajisur me një rrjet të brendshëm kompjuterik që mundëson lidhjen me internet në të gjithë ndërtesën. Faqja e internetit përditësohet rregullisht dhe inxhinieri TI është përgjegjës për mirëmbajtjen e pajisjeve. Informacioni që përdoret për përditësimin e faqes së internetit sigurohet nga departamentet dhe njësitë administrative duke siguruar saktësi **[M7; M8; M3; 4M]. [Kapitulli III Standardi VII.2]**
- 2.11 ASAR-i ka dy godina: në godinën kryesore janë të dyja fakultetet dhe mjediset e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ndërsa ndërtesa e dytë përdoret për zyra dhe aktivitete sportive. Ndërtesat i përkasin shoqërisë themeluese, Eskeld Sh.p.k **[36; 37; 39; 40; vizitë në terren]**. Ato i plotësojnë kushtet higjienike dhe sanitare të kërkuara dhe ka një sistem mbrojtje nga zjarri **[38; 37]**. ASAR-i ka një oborr 2000 m² të projektuar për aktivitete çlodhëse dhe rekreative të studentëve, dhe ka një kafene që ndodhet përkahe oborrit. **[vizita në terren]**. Ndërtesa nuk ka akses të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara; nuk ka rampë dhe nuk ka mbajtëse përgjatë shkallëve dhe as ashensor. Kjo trajtohet në fushën e vlerësimit nr. 5. **[Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.12 ASAR-i ka një protokoll për arkivimin e materialeve, për të ruajtur trashëgiminë akademike, kulturore dhe shkencore në përputhje me ligjin shqiptar **[RVV fq.21; Ligji nr. 7726, datë 29.06.1993; 33]**. Librat dhe literatura përkatëse e të gjitha programeve të studimit, si dhe tezat e doktoratës, botimet dhe tekstet shkollore të shkruara nga stafi akademik me kohë të plotë ruhen në bibliotekë. Konferencat shkencore të organizuara nga ASAR ofrojnë mundësi që stafi akademik të prezantojë dhe promovojë kërkimet e tyre. Ashtu sikurse edhe buletini që publikohet rregullisht. Biblioteka plotëson nevojat e studentëve për libra dhe po bëhen përpjekje për të pasuruar qasjen në burime elektronike. Kjo trajtohet në fushën e vlerësimit nr. 5. **[M8; turneu në terren; 69] [Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.13 ASAR-i ndodhet në zonën urbane të Vlorës, larg vendeve industriale. Ai siguron një infrastrukturë të përshtatshme për veprimtaritë e tij akademike, administrative dhe sociale, duke përfshirë klasa, zyra, salla mbledhje, një sallë të senatit akademike, një bibliotekë dhe laboratorë për të zhvilluar orët e mësimin, kërkimit dhe administrimin. Godina e ASAR-it është e ndriçuar mirë dhe e pajisur me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje.

Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të ndriçuara mirë dhe me dritare. Laboratorët janë të pajisur siç duhet për të përmbushur kërkesat e programeve. Të gjitha klasat monitorohen me kamera CCTV për siguri. Si ndërtesat edhe pajisjet i nënshtrohen një sistemi të rregullt të monitorimi dhe mirëmbajtje [74; 75]. **[Kapitulli III Standardi VII.5]**

- 2.14 ASAR-i ka një strukturë administrative, e cila ofron mbështetje në të gjitha nivelet. Strukturat organizative janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe statutin [1; 2]. ASAR-i luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të rajonit të Vlorës, duke ofruar profesionistë të trajnuar në fusha si farmacia, stomatologjia dhe fizioterapia, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës në Vlorë. ASAR-i bashkëpunon me një varg punëdhënësish dhe organizatash, të cilat ofrojnë mundësi që studentët të fitojnë përvojë në vendin e punës, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre, gjë që mbështet gjithashtu kontributin e Akademisë Reale në rajon. Kjo gjë është veçori e praktikës së mirë të shpjeguar në paragrafin 1.10. studentët dëshirojnë të hapin farmaci në zonat rurale, gjë që do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e rajonit të Vlorës [10; M3; M4; M6; M8]. Disa nga konferencat e ASAR-it mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional [100] dhe strategjia parashikon zhvillimin e një baze të shëndoshë kërkimore [10 pika 12, 13; M1; M7]. **[Kapitulli III Standardi VII.6]**
- 2.15 ASAR-i ka në pronësi dy godina. Godina kryesore, e ndërtuar në vitin 2001, ka klasa, laboratorë, zyrat e administratës dhe një kafene për studentët. Godina e dytë, e vendosur mbrapa, është aktualisht ambient i shkollës, por mund të përdoret në të ardhmen si hapësirë shtesë për stafin akademik, klasa dhe aktivitetet sportive. Në ambientet e mësimdhënies përfshihen laboratorët e kimisë, biokimisë, kimisë farmaceutike, stomatologjisë dhe anatomisë. Zona e klinikës dentare, infermierisë dhe fizioterapisë ofrojnë shërbim shëndetësor për vendasit, veçanërisht ata që janë më të moshuar dhe/ose në nevojë. Laboratorët kanë pajisjet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e mësimdhënies **[vizitë në terren; RVV fq.23]. [Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.16 ASAR-i ka krijuar dhe mirëmban sisteme të përshtatshme për të administruar dokumentacionin në mënyrë efikase në format të shtypur dhe elektronik. Ato administrohen dhe menaxhohen nga një administrator në zyrën kryesore. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e dokumentacionit të studentëve në format fizik. Këtu përfshihet edhe matrikullimi i kualifikimit të tyre, vlerësimet dhe statusi përparimit. Gjithashtu informacioni mbahet në një bazë të dhënash. Zyra është e hapur nga ora 08:00 deri në orën 16:00 për studentët e rinj që duan të regjistrohen dhe nga ora 14:00 deri në orën 16:00 për studentët në vitin e dytë dhe të tretë dhe në programet e Masterit Profesional **[vizitë në terren]**. Të dhënat e studentëve mbledhen me anë të plotësimit të një formulari përkatës, në momentin e parë të regjistrimit dhe përditësohen në vitet pasuese. Zyra e sekretarisë është e hapur për studentët për të marrë notat e provimeve dhe për të trajtuar çdo kërkesë që ka të bëjë me mësimdhënien. Gjithashtu, studentët mund të paraqesin ankesa që përcillen tek drejtuesit e departamenteve. Në rast se ankesa ka të bëjë me notën e vlerësimit, ngrihet një komision i përshtatshëm rishikimi [M3; M8]. Tezat e diplomave të studentëve ruhen në arkiv dhe vlerësimet e tyre, në varësi të detyrës, pasqyrohen në regjistra **[vizitë në terren; 33; 35; 76; 28]**. Baza e të dhënave bën të mundur të administratori të kryejë analiza statistikore të informacioneve kyç në formën e raportet të ecurisë së studentëve me renditjen e tyre sipas rezultateve të vlerësimit. Të gjitha të dhënat verifikohen dhe përmbushin kërkesat e MAS-it dhe të Agjencisë Kombëtare të Provimit (AKM). **[Kapitulli III Standardi V.2]**
- 2.17 ASAR-i ka një strukturë të qartë, të përshkruar në faqen në internet të Universitetit, që përfshin procesin e aplikimit dhe kriteret e rekrutimit të stafit akademik me kohë të

plotë dhe të pjesshme. Procedurat e rekrutimit përcaktohen në statutin dhe rregulloret e tij dhe stafi akademik është pjesë e procesit të rekrutimit. Kriteri kryesor i rekrutimit të stafit është përvoja dhe, sipas rastit, kërkohet me kualifikim në universitete të huaja. ASAR, në bashkëpunim me stafin akademik dhe studentët, luan një rol të rëndësishëm në rajonin e Vlorës, duke ndërmarrë aktivitete që kanë një ndikim social pozitiv. ASAR ka një mekanizëm vlerësimi të brendshëm për të vlerësuar stafin akademik dhe çdo departament i nënshtrohet këtij procesi. ASAR-i ka procedura transparente e të përshtatshme për menaxhimin e burimeve financiare, të cilat administrohen në përputhje me standardet dhe rregulloret e menaxhimit financiar publik. Pasqyrat vjetore i dorëzohen Ministrisë. Stafi akademik kontribuon në diskutime dhe propozime në momentin e caktimit të buxhetit. Rrjeti i bashkëpunimeve që ASAR ka krijuar është një praktikë e mirë.

- 2.18 ASAR-i mbështet zhvillimin e programeve të ofruara përmes ofrimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të përshtatshme. Pajisjet në klasa dhe laborator janë të mjaftueshme që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi teorike e praktike. ASAR siguron literaturën bazë të kërkuar nga programet e ofruara dhe është duke negociuar një marrëveshje me McGraw-Hill për të pasuruar më tej burimet.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk identifikoi asnjë tipar të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

Gjykimi

Standardet për burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Kërkesat e pranimit përshkruhen qartë në dokumentacionin e programit për ciklet e para dhe të dyta [6; 24] Në ditët e hapura për studentët e shkollave të mesme, stafi angazhohet [82] për t'i informuar ata mbi programet e ofruara dhe procedurat e hyrjes. Faqja në internet ofron informacion mbi programet për studentët [RVV fq.20] dhe publikun [RVV fq.25]. Studentët [M3; M4] gjejnë lehtësisht informacion rreth ASAR-it përmes reklamave në media, në faqen e internetit, fjalën e gojës dhe fletëpalosjet në shkollat e mesme [42]. Disa marrin materiale drejtpërdrejt nga zyra e ASAR. Ata e çmojnë informacionin të saktë dhe procesin e pranimit të qartë [M3; M4]. Studentët tërhiqen nga ASAR veçanërisht nga: raporti i ulët midis stafit dhe studentëve, ambientet, reputacioni i stafit dhe dashamirësia e tyre [M3; M4]. **[Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 ASAR-i nuk ofron arsimim të vazhdueshëm, por është një nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit [10] që përcaktohet edhe në RVV [RVV fq.44]. Pavarësisht se ASAR-i nuk ofron mësim me kohë të pjesshme, ai tërheq studentë të pjekur, veçanërisht në fushën e menaxhimit të biznesit pasi njerëzit me përvojë pune dëshirojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të fitojnë njohuri teorike [Vizita]. Në vitin 2016, u ofrua një seminar veror mbi metodat e kërkimit [faqja e internetit, maj 2017; RVV fq.26; 101]. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm që ofrohet në fushën e ofrimit së kujdesit shëndetësor është akredituar nga Qendra Kombëtare e Arsimit të Vazhdueshëm për Profesionistët e Shëndetit. Aktet nënligjore të kohëve të fundit qartësojnë mënyrën si duhet të ofrohet, gjë që do t'i japë mundësi ASAR-it të bëjë përpara në këtë fushë [RVV fq.26; M1]. **[Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.3 Strategjia e zhvillimit promovon mbështetjen e zhvillimit të aftësive profesionale në rajon [10] dhe rregulloret e programeve, të tilla si [7] Master shkencor në Farmaci, përfshijnë edhe vendin e dëshiruara të punësimit të studentëve. Broshurat e praktikës profesionale [21; 22] tregojnë si studentët mund të fitojnë nga mundësitë për praktikë profesionale në kuadër të studimeve të tyre. Studentët [M3] dhe punëdhënësit [M5] konfirmuan vlerën e këtij procesi. Stafi i ASAR-it dhe punonjësit, brenda ambientit përkatës profesional, mbikëqyrin studentët gjatë moduleve të praktikës profesionale ose stazhit [M3]. Studentët e infermierisë, në vitin e dytë dhe të tretë, kur janë në spitale dhe klinika, mbikëqyren nga afër nga një tutor i ASAR-it ose një infermier i spitalit [M3]. **[Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.4 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re prova që programet po zhvillohen nën dritën e nevojave rajonale, duke përfshirë një studim të turizmit në jug të Shqipërisë [79]. RVV-ja [RVV fq.27] thekson se programet zhvillohen në përputhje me strategjitë e Ministrive të Shëndetësisë dhe Arsimit. Partnerët që janë punëdhënës dhe profesionistë në fushat e tyre kanë mundësinë të diskutojnë kurrikulën me stafin e ASAR [M5] dhe ata janë të mendimit se programet janë të orientuara drejt ndaj nevojave të bizneseve dhe shërbimit shëndetësor. Stafi me kohë të pjesshme zakonisht është një profesionist i fushës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori shembuj si ata mbështeten në përvojën e tyre për të dhënë mësim. Një mjek, i cili është trajnuar për udhëzimet e ushqyerjes me gji nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si pjesë e një projekti në mbarë Vlorën, dëshiron ta përfshijë këtë temë në kurrikulë; dhe një dentist sigurohet që pacientët që vijnë nga zona të paraqesin probleme që kanë të bëjnë me tema që studentët janë duke i studiuar aktualisht [M6]. Kjo bën të mundur që studentët të shohin vlerën praktike, sociale dhe teknike të studimeve të tyre. Studentët, me të cilët Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua, treguan një angazhim të fortë ndaj zonës vendore. Disa dëshirojnë të hapin farmaci, pasi të diplomohen, në fshatra ku aktualisht nuk ka [M3; M4]. Ndërsa shumica e studentëve janë vendas, pak vijnë nga Italia [11] dhe një student turk që ka marrë ndihmë për të mësuar gjuhën shqipe. Suplementi i diplomës

lëshohet në gjuhën angleze dhe shqipe [24; 25; RVV fq.31]. **[Kapitulli I, Standardi I.4]**

- 3.5 Ka një procedurë me anë të së cilës mund të bëhet kërkesë për staf shtesë, pasi ngarkesa mësimore është llogaritur për vitin [72; 77; RVV fq.28; M2; M6]. Rregulloret e programeve përfshijnë numrin maksimal dhe minimal të studentëve. [7] Për Masterin shkencor në farmaci, numri i studentëve varion 7 -100, me grupe nga 25-30 për lëndët bazë dhe 12-15 për punë laboratorike. Ngarkesa e stafit është 6-8 orë mësim në javë [11] dhe ngarkesa e përgjithshme e punës është 50-70 për qind mësimdhënie, 20-30 për qind kërkim dhe zhvillim dhe 10-20 për qind mbështetje për institucionin [RVV fq.28]. Ngarkesat e punës së stafit administrohet duke siguruar kohë studimi për ata që janë duke studiuar për doktoratë ose që marrin pjesë në një konferencë [M6]. Fleksibiliteti i stafit me kohë të pjesshme bën të mundur një shpërndarje efikase të ngarkesës së punës të stafit [M2]. **[Kapitulli I, Standardi I.5]**
- 3.6 Informacioni rreth programeve dhe moduleve është i qartë dhe përfshin qëllimin dhe objektivat e programit, modulet individuale, koeficientët e vlerësimit dhe orët e studimit. Përdoren kredite ECTS [6; 25; RVV fq.29]. Në fillim të çdo viti, në leksionin e parë, stafi iu tregon studentëve se çfarë do të mbulojë plani [M3; M4; M6; RVV fq.29]. Rregulloret e Bachelorit shkencor për fizioterapi [6] tregojnë sfidat konceptuale që studentët duhet të zotërojnë për të zhvilluar dhe vlerësuar një hipotezë. Për bachelorin në menaxhim [25], plani i moduleve përmban edhe një listë të shkurtër leximi, zakonisht një ose dy libra të detyrueshme dhe një ose dy libra fakultativë. **[Kapitulli I Standardi I.6]**
- 3.7 Rregulloret e programit përcaktojnë modelin e studimit që në ciklin e parë fillon me një nivel bazë dhe u siguron studentëve njohuri dhe aftësitë themelore [6; 25]. Përdoret sistemi i ECTS-ve [RVV fq.29; 1]. Zakonisht, në vitin e parë, studentët studiojnë më shumë teori dhe më pas, në vitet e mëvonshme të programit, vihen në kontakt me pacientë dhe praktika [M3] pasi kanë fituar dije dhe besim. Kjo siguron që ata të kuptojnë paraprakisht parimet përpara se t'i zbatojnë në praktikë. Rregulloret e programeve përcaktojnë gjithashtu mënyrën e vlerësimit. Në Bachelor për menaxhim, vlerësimi është 70 për qind provim, 30 për qind detyrë kursi [25] dhe informacioni i hollësishëm i programit përmban shpjegime edhe për mbrojtjen e diplomës përpara një komisioni. Rregulloret e Bachelorit për fizioterapi [6] përfshijnë notat e vlerësimit si përqindje e pikëve dhe pastaj me rend alfabetik. Gjithashtu, rregulloret përcaktojnë rregullat e rivlerësimit dhe kërkesat e frekuentimit (100 për qind e të gjitha seanceve). studentët kuptojnë se çfarë kërkohet prej tyre [M3] dhe marrin komente pas provimeve për fushat kryesisht më problematike për ta, në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë kanë bërë keq dhe të përmirësohen. Për nota të veçanta, mund të marrin komente individuale, [M3] nëse nuk janë të qartë pse iu është dhënë ajo notë. ZKK këshillon studentët për zgjedhjet e tyre të studimit, si dhe mundësitë e tyre të punësimit. Ajo madje i ndihmon studentët që mund të mendojnë të lënë programin të gjejnë një rrugë më të përshtatshme për të ecur përpara [M7]. Shkalla e punësimit të të diplomuarve monitorohet, [26] ashtu sikurse edhe shkalla e kalueshmërisë [8] që qëndron në 100 për qind. Kjo siguron besimin se të diplomuarit e ASAR-it janë të pajisur mirë për punë dhe kjo mbështetet nga punëdhënësit partnerë [M5]. **[Kapitulli I Standardi I.7]**
- 3.8 Struktura e programit të ciklit të parë zhvillon dijet e studentëve dhe më pas i mundëson t'i vendosin ato në praktikë (shiko gjithashtu paragrafin 3.7). Për më tepër, studentët kanë një marrëdhënie të mirë me stafin dhe në çdo moment mund të kërkojnë ndihmë [M3; M4]. Ata mbështeten fuqishëm nga tutorët e ASAR-it [M3] dhe nga mbikëqyrësit e tyre në praktikën profesionale [M5]. Stafi shpjegon programin e studimit në fillim të vitit ose semestrit, duke i dhënë grupit një orar javor të temave [M3; M6]. Ata janë aktivë në identifikimin e shembujve nga jeta reale, duke përfshirë

studimin e rasteve nga praktika e tyre profesionale për të nxitur interesin e studentëve **[M6]**. Shembujt përfshijnë raste ligjore dhe raste të vërteta klinike **[M6]**. Stafi e shoqëron mësimin me diapozitiva për ta bërë më aktiv **[M6]** dhe kur studentët kanë kërkuar që në klasa të shtohen ilustrime me diapozitiva **[M4]** për të siguruar një stimulim pamor për të nxënë, kjo gjë është bërë. **[RVV fq.30]** Metodatat e mësimdhënies synojnë të përthithen lehtësisht në fillim të periudhës së studimit dhe sistemi me tutor është projektuar për të mbështetur tranzicionin e studentëve në arsimin e lartë **[RVV fq.30]**. Një nga anëtarët e stafit i shpjegoi grupit të vlerësimit se gjatë orës së parë, kur ka dy orë radhazi, ajo përpiqet të mos e bëjë shumë të vështirë, por më pas gjatë orës së dytë kontrollon nëse studentët kanë kuptuar atë që iu është thënë **[M6]**. Një tjetër shfrytëzon anëtarësimin e tij në një shoqatë profesionale për të mësuar rreth praktikave ndërkombëtare të mësimdhënies, të cilat mund t'i përfshijë në klasat e tij **[M6]**. Të gjitha këto qasje i ndihmojnë studentët të përshtaten me mësimin dhe studentët e vlerësojnë mbështetjen që marrin nga stafi **[M3, M4]**. Raporti i ulët i studentëve ndaj stafit e bën të mundur këtë gjë (shiko gjithashtu paragrafin 5.1). Disa punonjës të sapo punësuar kanë shumë përvojë **[M6; turi në terren]** dhe mund të mbështesin e ndihmojnë kolegët më të rinj në moshë për të përdorur më së miri orët e mësimin. Këshillat përfshijnë mënyrën e ndarjes së kohës ndërmjet punës praktike dhe teorike, çfarë literature duhet përdorur dhe si të administrohen leksionet dhe seminarët. Kjo mund të kërkojë që stafi të marrë pjesë në orët e mësimdhënies së njëri-tjetrit **[M6]**. Personeli pa doktoratë nxitet për t'i marrë ato në mënyrë që mësimdhënia e tyre të pasurohet nga procesi i kërkimit **[M6]**. **[Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.9 Në ciklin e dytë, Masterat Shkencor për stomatologji dhe farmaci janë objekt akreditimi profesional **[RVV fq.31]**. Kurrikula **[24]** dhe rregulloret **[6]** e Masterit Shkencor për farmaci përcaktojnë njohuritë që studentët duhet të fitojnë dhe aftësitë më të thella intelektuale që lidhen me dhënien e Masterit. Qëllimi është të përgatiten specialistë që mund të punësohen ose të vazhdojnë me studimet e tyre, duke dëshmuar angazhim ndaj të nxënësve gjatë gjithë jetës. Punëdhënësit partnerë janë mbështesin fuqimisht mendimin se studentët janë të përgatitur mirë, me aftësitë dhe njohuritë që kërkohen në vendin e punës **[M5]**. Praktikantët zhvillohen në fund të programeve në mënyrë që studentët të mund të aplikojnë njohuritë e tyre në vendin e punës **[M4]**. Kjo gjë është veçori e praktikës së mirë të shpjeguar në paragrafin 1.10. **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.10 Vlerësimi në fund të programit të Masterit profesional përqendrohet në zbatimin e aftësive profesionale. Studentët e stomatologjisë vlerësohen duke punuar në kokat e manekinëve dhe jo thjesht mbi bazën e njohurive teorike të marra **[M4]**. Rregullorja e Qendrës Kërkimore Shkencore përcakton si qëllim integrimin e kërkimit në mësimdhënie **[85]** gjë që do të mbështesë programet e ciklit të dytë. Kurrikula **[24; 6]** përfshin hollësi si ndarja e orëve të studimit dhe përshkrimin e detajuar të moduleve. Vlerësimi i Masterit shkencor bazohet në një sistem pikësh, të cilat konvertohen në nota. **[24]**. Ka rregullore në lidhje me vlerësimin duke përfshirë edhe rivlerësimin **[24]**. **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.11 Programet përdorin sistemin ECTS dhe janë në përputhje me Bolonjën **[RVV fq.30-31; M6]**. Stafi e konsideron këtë si çështje kyç për të siguruar standardet ndërkombëtare dhe për të mundësuar studentët të kenë mundësi studimi diku gjetkë **[M6]**. Ka lidhje bashkëpunimi me institucione të tjera, duke përfshirë një marrëveshje me Universitetin e Salernos, që mundëson programe të përbashkëta ose zhvendosjen e studentëve në Salerno për programin e Masterit **[M1]**, por përdorimi i këtyre mundësive është shumë i kufizuar **[RVV fq.43; M1, M2; M3; M4; M6]**. Rajoni i Vlorës është i përfshirë në skemën Erasmus + **[M6]** dhe ASAR-i po punon me rajonin vendor për të aplikuar për projekte kërkimore të financuara nga Erasmus. Partnerët e mundshëm janë Italia dhe Mali i Zi **[M5]**. Gjithashtu, janë duke u zhvilluar diskutime për marrjen e financimit, në kuadër të projektit INTERREG, për një projekt ndërkufitar shqiptaro-grek me

Universitetin e Korfuzit [M1]. Studentëve iu kërkohet zotërimi i një gjuhe të huaj (anglisht) përpara regjistrimit [RVV fq.31] për të mbështetur mundësitë e tyre për zhvillim më të gjerë profesional. Nëse Departamenti i Farmacisë fiton anëtarësimin në Shoqatën Evropiane të Fakulteteve të Farmacisë [3; RVV fq.3; M6] pritet që të mbështetet dhe nxitet mobiliteti. Studentët dëshirojnë të kenë mundësi të studiojnë për kualifikimin e gjuhës angleze para Masterit në ASAR [M3]. **[Kapitulli I Standardi I.10]**

- 3.12 Për programet e fakultetit të mjekësisë, ka evidenca të zbatimit në praktik të teorisë, duke përfshirë një modul të praktikës profesionale me 20 kredite në farmaci [24] dhe mundësi praktike në fizioterapi [21; 22]. Broshura e praktikës iu shpjegon studentëve se çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë si pasojë e kryerjes së praktikës profesionale në fizioterapi dhe përmban edhe një ditar ku ata mund të regjistrojnë zhvillimin e tyre profesional [21; M6]. Studentët e biznesit kanë një përvojë të ngjashme në vitin e fundit të programeve të tyre [M3; M5]. Punëdhënësit janë veçanërisht pozitivë në lidhje me potencialin që kanë këta të diplomuar për të transformuar bizneset familjare me anë të ekspertizës së tyre, ose për të siguruar që hotelet dhe veprimtaritë e tjera që lidhen me turizmin të funksionojnë në mënyrë profesionale [M5]. Studentët dhe punëdhënësit e lavdërojnë lart përvojën e praktikës profesionale që studentët marrin dhe që i bën ata të gatshëm për tregun e punës [M3; M4; M5]. Përvoja e stafit me kohë të pjesshme, të cilët janë gjithashtu profesionistë që ushtrojnë profesionin, iu jep mundësi atyre që të sjellin në klasë raste nga jeta reale (shiko gjithashtu pikat 3.4 dhe 3.8). Studentët e stomatologjisë dhe fizioterapisë trajtojnë njerëzit vendas nën mbikëqyrje, pa pagesë **[vizitë në terren]**. **[Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.13 Kurrikula e Masterit Shkencor për farmaci [24] ka për qëllim të përgatisë specialistë që mund të punësohen dhe të vazhdojnë studimet e tyre, duke treguar angazhim ndaj të nxënies gjatë gjithë jetës. Kurrikula e Bachelorit për menaxhim [25] përfshin edhe deklaratë të llojit të punës që të diplomuarit pritet të jenë në gjendje të kryejnë (në nivelin e menaxherit). Punëdhënësit [M5] konfirmojnë se këto aspirata janë realiste. ZKK mbështet këtë qëllim [29; RVV fq. 32] pasi sfera e përgjegjësisë të saj është që t'i pajisë studentët me këshilla për "rrugën" e studimit [29], të cilat lidhen me aftësitë e studentëve dhe aspiratat e karrierës. Gjithashtu, ZKK organizon [19. M7] seminare të hapura për tema që përfshijnë shkrimin e një CV-je, letrave të motivimit [M3] dhe përgatitjen për intervistë pune. Studentët konfirmojnë se ZKK i ndihmon ata të kërkojnë në tregun e punës dhe i këshillojnë për vendet e punës në rajon [M3]. **[Kapitulli I Standardi I.12]**
- 3.14 Kurrikula në ASAR është hartuar duke marrë parasysh nevojat shoqërore dhe të tregut të punës në rajon dhe perspektivat e punësimit të studentëve. Programet i ofrojnë studentëve dije teorike në fazat e para, pas të cilave i zbatojnë këto njohuri në situata praktike. Kjo iu jep mundësi të përshtaten me studimet dhe të zhvillojnë aftësitë që do t'i bëjnë ata të punësohen më lehtë sektorin e shëndetësisë ose në biznes. Pacientët nga zona vendore vijnë në ASAR për lloje të caktuara trajtimi shëndetësor. Kjo gjë iu jep studentëve mundësi të jenë në kontakt me pacientëve qysh në fillim të studimeve të tyre dhe ka module të praktikës profesionale dhe stazh për të gjithë studentët, zakonisht në vitin e fundit të programit të tyre. Programet e Masterit Profesional shtrihen gjatë një periudhe më të gjatë studimi, e cila lejon zhvillimin e aftësive më të sofistikuar. Punëdhënësit kanë mbresa shumë pozitive nga studentët dhe të diplomuarit me të cilët janë hasur; studentët janë të zotuar për të punuar në zonën vendore përreth; dhe bashkëpunimet që i mbështesin këto janë një praktikë e mirë. Kurrikula lejon që stafi të mbështetet në përvojën e tij profesionale për të ofruar studime të rasteve duke demonstruar ndikimet praktike të lëndëve të mësuara. Programet përshkruhen qartë në dokumentet përkatëse. Përdoret ECTS-të dhe jepet një suplement diplome.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk identifikoi asnjë tipar të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimi të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

Gjykimi

Standardet për kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Programet e ciklit të parë dhe të dytë të ofruara në ASAR janë të dokumentuara në mënyrë të plotë për sa i takon kërkesave të pranimit, përmbajtjes së programit e të lëndës dhe metodat e vlerësimit [24; 25; 32]. Shpërndarja e personelit mësimor dhe e burimeve të të nxëniet (hapësira laboratorike, pajisjet, qasja në praktikë dhe vendosja në vende për të kryer praktikë) koordinohet dhe monitorohet sistematikisht [21; 22; 24; 25]. Janë planifikuar me kujdes vendosja në dispozicion e literaturës së duhur dhe e burimeve të bibliotekës dhe ka burime të përshtatshme, pavarësisht se do të përfitohej më shumë nga aksesimi më i madh në burimet elektronike (shiko gjithashtu paragrafin 5.5) [M2; M7]. Përcaktimet e detajuara të programit dhe përshkrimet individuale të kurseve janë në dispozicion për të gjitha diplomat e dhëna nga ASAR [21; 22]. Ato rishikohen rregullisht nga stafi mësimor për të siguruar që janë të përditësuara dhe të përshtatshme [RVV; M6]. Çdo ndryshim i nevojshëm i kurrikulës miratohet nga Këshillat përkatës të Fakultetit dhe pastaj nga Senati Akademik. Studentët konfirmuan pasjen e pajisjeve dhe materialeve laboratorike të nevojshme, të literaturës përkatëse, qoftë nga biblioteka e ASAR-it ose në internet, si dhe mbikëqyrja sistematike nga ASAR-i i praktikave dhe vendeve të praktikave [M3; M4]. [Kapitulli I Standardi II.1]
- 4.2 Vlerësimi i studentëve drejtohet nga rregulloret akademike, të cilat përcaktojnë përqindjen e fituar nga frekuentimi, kurset dhe provimet përfundimtare [2; 27]. Rregullorja përcakton gjithashtu mënyrën si provimet planifikohen në kohë, kryhen dhe vlerësohen, duke përfshirë mënyrën si studentët mund të paraqesin ankesa [2]. Studentët marrin informacion për vlerësimin e kurseve individuale drejtpërdrejt nga pedagogët e tyre dhe gjithashtu përmes portalit të studentëve [RVV]. Metodatat e vlerësimit e kurseve individuale paraqiten në përshkrimet e kurseve [24; 25]. Vendosja e notave bëhet nga të paktën dy anëtarë të stafit akademik dhe mbikëqyrjet nga drejtuesi përkatës i departamentit [2; M7]. Studentët e diplomuar pajisen me një suplement të detajuar të diplomës, ku përshkruhet përmbajtja, niveli dhe konteksti i studimeve të tyre [24; 25]. Studentët që u takuan nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm treguan se ata marrin udhëzime mbi përmbajtjen dhe metodat e vlerësimit drejtpërdrejt nga pedagogët e tyre, si dhe në udhëzimet e kurseve të dhëna në fillim të çdo semestri. Studentët kanë dijeni si për rrugët formale dhe joformale për të paraqitur ankesa [M3; M4]. [Kapitulli I Standardi II.2]
- 4.3 ASAR-i ka procedurë për rishikimin e rregullt të të gjitha programeve që ai ofron dhe të përparimit të studentëve dhe cilësisë së mësimdhënies [RVV; 8]. Studentëve iu kërkohet të plotësojnë pyetësorë për të gjitha kurset e tyre [36; 56]. Përveç kësaj, çdo vit, stafit i kërkohet të rishikojë kurset që kanë dhënë mësim duke i kushtuar rëndësi të veçantë rezultateve të studentëve, vlerësimeve të studentëve dhe ankesave të studentëve. Në secilin departament, një grup nga stafi shqyrton çdo vit se çfarë rishikimesh duhen bërë në formën e programit, vlerësimit dhe mësimdhënies [RVV; 35]. Këto burime evidencash shqyrtohen çdo vit nga NjSBC-ja dhe harton një raport vjetor për Senatin dhe Këshillin Drejtues. Raporti përmban rekomandime për përmirësime të mëtejshme ose ndryshime që më pas përfshihen në planet e veprimit [8; 56; 80; M1; M7]. Në kohën e këtij vlerësimi të jashtëm, ishin futur rishtazi vlerësimi i studentëve dhe stafit si mekanizëm për të mbledhur informacion për strategjinë e zhvillimit 2016-21, si dhe një analizë SWOT për pikat e forta dhe të dobëta të Akademisë [10; 57]. [Kapitulli I Standardi II.3]
- 4.4 ASAR-i monitoron cilësinë e të nxëniet dhe mësimdhënies kryesisht përmes NjSBC-së, e cila kontribuon në vendimet për zhvillimin e stafit [M1; M7; 35]. Duke marrë parasysh madhësinë relativisht të vogël të institucionit, zhvillimi i stafit menaxhohet kryesisht

përmes mekanizmave joformalë [M6]. Stafi i ri dhe me përvojë kombinohen bashkë për të diskutuar problemet që lindin në mësimdhënie dhe i gjithë stafi të marrë pjesë në shqyrtimet vjetore të programeve [35; M2; M6]. Stafi më i ri nxitet dhe mbështetet për të fituar kualifikime të mëtejshme [M2; M6]. **[Kapitulli I Standardi II.4]**

- 4.5 ASAR-i mbështet kërkimin në fushat që kanë lidhje me mësimdhënien e tij, me anë të një Qendre Kërkimore në nivel institucional dhe, gjithashtu, në nivel të gjashtë departamenteve të tij të cilat monitorojnë dhe koordinojnë aktivitetet kërkimore dhe botuese të stafit [11; RVV; M6]. Qendra e Kërkimit propozon një shpërndarje vjetore të fondeve për të mbështetur veprimtaritë kërkimore të stafit që miratohet nga Bordi i Drejtorëve [dokumentet 67; 88]. Kërkimi i kryer nga stafi është botuar në një revistë kërkimore të ASAR-it dhe stafi përfshihet në konferenca shkencore ndërkombëtare, si në Vlorë ashtu edhe jashtë [15; 59; 62; 69; M6]. **[Kapitulli II Standardi I.1, I.2]**
- 4.6 Sipas strategjisë së zhvillimit 2016-2021, ASAR është i angazhuar ndaj zhvillimit të kërkimeve mjekësore dhe ekonomike të rëndësishme për rajonin dhe ndërkombëtarisht [10]. ASAR-i ka nënshkruar marrëveshje formale me universitete në Shqipëri dhe në nivel ndërkombëtar për të zhvilluar bashkëpunime kërkimore e mësimore, megjithëse në kohën e këtij vlerësimi nuk ishte marrë ende ndonjë rezultat i rëndësishëm [16; M1; M6]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re evidenca që dëshmojnë se stafi i ASAR ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në konferenca shkencore ndërkombëtare [62; 82; 99]. Në kohën e këtij vlerësimi të jashtëm, ASAR-i kishte përfunduar së fundmi një aplikim të përbashkët për financim nga projekti INTERREG i BE-së, në bashkëpunim me akademikë nga Italia, Mali i Zi, Korfuzi dhe Greqia [M5]. Duke qenë se ASAR është themeluar së fundmi, pritet që ndërkombëtarizimi i kërkimit të jetë relativisht i pazhvilluar. Megjithatë, ishte e qartë nga evidencat që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa dhe dëgjoi se ASAR ka struktura dhe burime që kanë gjasa të rrisin bashkëpunimin kërkimor dhe rezultatet në të ardhmen. **[Kapitulli II Standardi I.3]**
- 4.7 Kërkimi nga stafi dhe studentët e ASAR-it inkurajohet në një sërë mënyrash. Brenda gjashtë departamenteve, janë ngritur grupe kërkimore individuale akademike dhe udhëhiqen nga staf me përvojë [M6]. Qendra e Kërkimit e ASAR monitoron dhe raporton mbi aktivitetet e kërkimit në Senatin Akademik dhe në Bordin e Drejtorëve [67; 85; 87; 88]. Stafit që studion për doktoratë i jepet kohë për kërkimin [70; M6]. **[Kapitulli II Standardi I.4]**
- 4.8 ASAR-i ka përcaktuar politikat dhe çështjet me përparësi për veprimtarinë kërkimore që do të kryhet nga stafi i tij dhe studentët, të cilat janë në përputhje me rolin e tij si një akademi që ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë në shkencat mjekësore dhe ekonomi [1; 2]. Objektivat kërkimorë të Akademisë janë të lidhura me përparësitë e punësimit dhe zhvillimit të rajonit [8; 61; M5]. Personeli me kohë të plotë dhe të pjesshme duhet të kenë kualifikimin e duhur shkencor dhe rregullorja përcakton mbrojtjen e duhur të lirisë akademike dhe miratimin etik të kërkimit [2; 5; 53]. Veprimtaria kërkimore koordinohet nga Qendra e Kërkimit e institucionit dhe sigurohet financim për të mbështetur veprimtaritë kërkimore të stafit [88]. Kërkimi i kryer nga stafi publikohet në buletinin gjashtë mujor të kërkimit të ASAR-it dhe në revistat ndërkombëtare [62; 69; 82]. Për identifikimin e nevojave për kërkime, ASAR-i bashkëpunon me Bashkinë e Vlorës, Këshillin e Qarkut Vlorë dhe spitalet e klinikat dentare vendase [RVV; M5]. Mendimi i grupit të vlerësimit është se veprimtaria shkencore dhe kërkimore e kryer nga ASAR është në përputhje me madhësinë, zhvillimin dhe fushat në të cilat ai ofron programe akademike. **[Kapitulli II Standardi I.5-1.8]**

4.9 Përparësitë e mësimdhënies dhe kërkimit të ASAR janë projektuar për të përfituar dhe për të përmbushur nevojat e rajonit dhe të kombit. Të gjashtë programet mësimore të ofruara nga Akademia kanë për qëllim të përmbushin nevojat e punësimit të rajonit për stomatologji, infermieri, fizioterapi e farmaci, si dhe për menaxhim e turizëm. Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë sistematike. Akademia rishikon në mënyrë të rregullt performancën e stafit dhe rezultatet e studentëve dhe përcakton objektiva vjetore dhe strategjike për përmirësim. Aktivitetet e kërkimit dhe publikimit të stafit janë të përshtatshme për madhësinë dhe fokusin e institucionit dhe kanë burime të mjaftueshme dhe monitorohen.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë tipar të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Akademia publikon përshkrime të qarta të programeve që ofron në faqen e saj në internet dhe në fletëpalosjet e shpërndara në shkollat e mesme [RVV; dokumentet 42; 66; M3; M4]. Gjithashtu, stafi i Akademisë viziton shkollat dhe programet akademike reklamohen në televizionin vendor [66; M3]. Procesi i aplikimit dhe pranimit është standardi për Shqipërinë dhe lejon studentët të aplikojnë deri në 10 institucione [32]. ASAR-i zhvillon gjithashtu “javën e hapur” kur aplikantët e mundshëm mund të vizitojnë akademinë dhe të takojnë stafin që jep mësim në programet që ata janë të interesuar [M3; M4]. Akademia është e hapur për studentët e huaj dhe, në kohën e këtij vlerësimit, qysh nga koha e hapjes, ishin pranuar gjashtë studentë të huaj [RVV; M2]. Studentët me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konfirmuan se informacioni për akademinë dhe programet e saj merrej lehtësisht dhe se procesi i pranimeve funksiononte mirë. Akademia organizon ngjarje orientuese për studentë fillestarë. Përgjegjësit e të gjashtë departamenteve bëjnë një prezantim verbal të planit, orëve të mësimit dhe peshës së krediteve, që janë në përputhje me sistemin e Bolonjës [M3]. Raporti i studentëve ndaj stafit është i ulët dhe kjo ka tërhequr disa nga aplikantët që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi. Gjithsej raporti staf ndaj student është 1:6 dhe i tejkalon kërkesat kombëtare, si për klasat ashtu edhe për laboratorët e mësimit [RVV; M3; M4]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shpreson që ASAR-i të jetë i aftë të mbajë këtë karakteristikë pozitive teksa rritet. [Kapitulli I Standardi III.1]
- 5.2 ASAR-i komunikon me studentët e tij përmes takimeve prezantuese dhe takimeve në klasë, portalit të studentëve, postës elektronike dhe medias sociale [RVV; M3; M4]. Gjithashtu, studentët marrin udhëzues të printuar dhe orientime për programet dhe kurset, ndërsa informacione të rëndësishme vendosen në tabelën e njoftimeve [RVV; M3; M4; M5]. Të dhënat e studentëve mbahen nga zyra e administratës, si dhe në një sistem të dhënash në internet që menaxhohet nga zyra e TI-së. Të dhënat për studentë individualë (detajet e regjistrimit, arritjet dhe përparimi i studentit) mbahen në një bazë të dhënash që kontrollohet nga Sekretaria Akadematike [RVV; M7]. Në kohën e këtij vlerësimi të jashtëm, Akademia ishte në proces përditësimi të bazës së të dhënave të studentëve për të lejuar akses më të lehtë në internet [M7]. Studentët dhe stafi që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi konfirmuan se metodat e komunikimit që përdorur ASAR-i janë gjithëpërfshirëse dhe të besueshme [M3; M4; M6]. [Kapitulli I Standardi III.2]
- 5.3 Përveç udhëzimeve, këshillimit dhe orientimit të studentëve të përshkruar në paragrafin 5.1, çdo student ka një tutor personal tek i cili mund të marrin si këshilla akademike ashtu edhe personale. Për çdo vit studimi, caktohet nga një tutor i ri [M6]. Studentët në vitin e fundit, që kryejnë praktikën në spitale apo farmaci, kanë nga një tutor të brendshëm të Akademisë dhe një tjetër nga stafi i vendit ku kryejnë praktikën [M4; M6]. Për studentët që dëshirojnë të ndryshojnë kurset, ka në dispozicion udhëzime të përgjithshme, pavarësisht se këto ndryshime janë të rralla [RVV; M7]. [Kapitulli I Standardi III.3]
- 5.4 Akademia zbaton një politikë pranimi jo diskriminuese dhe trajton në mënyrë të barabartë edhe aplikime nga grupet e pakicave [M2; 65]. Mundësia për t'u angazhuar në aktivitete sportive në institucion është e kufizuar vetëm me një fushë të vogël basketbolli, por një gamë e gjerë mundësish kulturore dhe sportive ofrohen në bashkëpunim me organizata të tjera [RVV; 18; 98]. Pavarësisht se Akademia ofron trajtimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë të trajnimit të fizioterapisë dhe infermierisë, godina nuk ka akses për përdoruesit e karrigeve me rrota [M3, turne në faqen]. Faktin që godina nuk është e sigurt për studentët dhe vizitorët me aftësi të kufizuara, veçanërisht të atyre me probleme të lëvizjes, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si dobësi. Për rrjedhojë Kapitulli I, Standardi III.4 nuk përmbushen dhe

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që godina të bëhet e sigurt dhe miqësore për t'u përdorur nga studentë dhe vizitorë me aftësi të kufizuara, duke shtuar binarë udhëzues në hyrje dhe në shkallë, si dhe të ndërtohet një rampe në hyrje, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar. **[Kapitulli I Standardi III.4]**

- 5.5 Biblioteka e Akademisë me rreth 1.200 libra është e hapur çdo ditë prej orës 8:30 deri në orën 17:30. Stoku i librit në bibliotekë përbëhet kryesisht nga tekstet bazë të rekomanduara për kurset e ofruara. Departamenti i TI-së është në proces krijimi të një katalogu digjital të fondit të bibliotekës **[M7]**. ASAR planifikon blerjen e librave për bibliotekën duke përdorur një buxhet trevjeçar të orientuar nga kërkesat e kurrikulës **[RVV; M6; M7]**. Studentët, që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi, konfirmuan se ata kanë mundësi të marrin tekste si në gjuhën shqipe edhe në gjuhë të huaja që kërkohen për kurset e tyre **[M3; M4]**. Akademia është duke negociuar marrëveshjet përfundimtare për të blerë akses në sistemin e librave elektronikë online nga McGraw-Hill, për të siguruar akses në një numër më të madh tekstesh shkollore dhe revistash akademike e teknike **[RVV; M7]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm beson se ASAR duhet të bëjë përpara me këto plane, të cilat do të forcojnë pajtueshmërinë e tij me Kapitullin 1 Standardi III.5, dhe prandaj pohon që ASAR-i të përfundojë zhvillimin e një katalogu bibliotekar në linjë dhe të zbatojë marrëveshjen me McGraw-Hill për qasjen në libra elektronikë. **[Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.6 Studentët e ciklit të parë marrin udhëzime nga lektorët dhe tutorët e tyre personalë **[86; M6]**. Gjithashtu, studentët kanë mundësi të marrin këshillime dhe seminare që ofrohen nga Zyra e Karrierës. Kjo është diçka shtesë nga udhëzimet që jep stafi mësimdhënës dhe përqendrohet në ndikimet që ka zgjedhja e programeve dhe kurseve në punësim dhe karrierë **[19; M7; RVV]**. Stafi i Zyrës së Karrierës ofron këshilla individuale për shkrimin e aplikimit për punësim dhe hartimin e CV-ve, të mbështetura nga një bazë të dhënash të vendeve të punës në rajon **[M3]**. **[Kapitulli I Standardi III.6]**
- 5.7 Statuti i ASAR-it parashikon ngritjen e këshillave studentorë në nivel institucional dhe departamenti, si dhe përfaqësimin e studentëve në organet kryesore të Akademisë: Senat Akademik, Këshillat e Fakultetit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) **[1; RVV]**. Këshilli Studentor mund të aplikojë në Këshillin e Administrimit për mbështetje financiare për aktivitete të veçanta **[87]**. Këshilli Studentor përbëhet nga dy përfaqësues të zgjedhur për secilin departament dhe Këshilli më pas zgjedh një kryetar për vitin. Këshilli Studentor diskuton të gjitha çështjet që prekin studentët dhe mund të paraqesë kërkesa dhe ankesa tek drejtuesit e departamenteve, dekanët e fakulteteve dhe Senatin Akademik. Dëshmitë që mori Grupi i Vlerësimit të Jashtëm treguan se Këshilli Studentor dhe përfaqësimi i studentëve në organet e ASAR-it funksionojnë në mënyrë efikase dhe janë të aftë të trajtojnë një sërë problemesh të studentëve **[M3; M4]**. Evidencat tregojnë gjithashtu se Këshilli Studentor luan një rol të rëndësishëm në jetën e studentëve në komunitet, si: organizimi i festave, organizimi i punës vullnetare në komunitet nga studentët, siç janë si ndihma e njerëzve të prekur nga përmbytjet ose dhurimi i gjakut për bankën e gjakut të spitalit **[M3; M4]**. Studentët që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm binin dakord se sistemet e përfaqësimit të studentëve punojnë në mënyrë efikase dhe kontribuojnë në një ndjenjë solidariteti midis studentëve **[M3; M4]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e çmon efikasitetin e Këshillit Studentor, përfshirë angazhimin e tij ndaj veprimtarive që rrisin mirëqenien e njerëzve të zonës, si **praktikë të mirë**. **[Kapitulli I Standardi III.7]**
- 5.8 Ambientet sportive janë të kufizuara siç u tha në paragrafin 5.4. Këshilli Studentor organizon aktivitete sociale dhe vullnetare me mbështetjen e Akademisë **[RVV; 18; 87; M3; M4]**. ASAR është shumë i vogël për të ofruar shërbime shëndetësore për studentët e tij, por stafi dhe studentët kanë lidhje të ngushta me shërbimet mjekësore vendore dhe shërbime të tjera **[M5; M6]**. Zyra e Karrierës organizon seminare dhe

aktivitete të tjera si vizita që lidhen me mundësi punësimi [19; M7]. [*Kapitulli I Standardi III.8*]

- 5.9 Misioni i ASAR përqendrohet në përmbushjen e nevojave për aftësi të tregut të punës në rajonin e jugut dhe Akademia dhe stafi i saj akademik janë të lidhur ngushtë me institucionet publike dhe private, si spitalet, praktikat dentare, farmacitë dhe hotelet [1; 2; 8; 10; 62]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi një grup punëdhënësish të rëndësishëm lokalë, të cilët konfirmuan se ASAR-i e ka veçanërisht të lehtë të komunikojë dhe për t'iu përgjigjet shpejtë përparësive ekonomike lokale dhe nevojave të tregut të punës [M5]. ZKK-ja luan një rol të rëndësishëm në jetën e Akademisë dhe karrierën individuale. Këshillimi për punësim është gjithmonë në dispozicion të studentëve [M2; M3; M4; M7]. Një pjesë e rëndësishme e përgatitjes së studentëve për punësim është vendosja në praktika pune dhe stazhi, veçanërisht në vitin e fundit të programeve profesionale [20; 21; 60; M4; M5; M6]. [*Kapitulli I Standardi III.9*]
- 5.10 ASAR-i ka procedura efikase për pranimin, orientimin, mësimin dhe vlerësimin e studentëve që janë në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe vendor. Informacioni për programet e ofruara dhe kurset individuale është i dokumentuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në dispozicion të publikut. Personeli i punësuar nga ASAR-i rekrutohet me kujdes, ka kualifikimin dhe përvojën e duhur për të dhënë si trajnim akademik edhe praktik të kërkuar nga programet. Studentët e diplomuar marrin certifikata dhe suplement diplome që janë në përputhje me standardet e certifikimit të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane. Raporti bujar staf-student prej 1:6 dhe ofrimi i plotë i mbështetjes administrative dhe udhëzimit të karrierës janë karakteristika pozitive. Studentët që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi dëshmuar se ata kanë zgjedhur të ndjekin ASAR-in për shkak të mbështetjes së individualizuar që ofron si në edukimin akademik ashtu edhe në vendosjen në praktika. Përfaqësimi i studentëve në organet kryesore vendimmarrëse të Akademisë dhe përmes Këshillit Studentor funksionon në mënyrë efikase. Qasja aktive e Këshillit Studentor është një praktikë e mirë. Mbështetja e bibliotekës dhe TI-së, së bashku me aksesin në hapësirën dhe pajisjet laboratorike si në ASAR ashtu edhe në praktikat e punës janë të kënaqshme, por ASAR-i duhet të përfundojë negociatat për të siguruar akses më të gjerë në burime elektronike të bibliotekave. Mungesa e qasjes së sigurt për njerëzit me probleme në lëvizje është një dobësi.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- efikasiteti i Këshillit Studentor, si dhe zotimi i tij ndaj veprimtarive që rrisin mirëqenien e banorë të zonës (pika 5.7; *Kapitulli I Standardi III.7*).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- godina nuk është e sigurt për studentë dhe vizitorë me aftësi të kufizuara, veçanërisht ato me probleme të lëvizjes (pika 5.4; *Kapitulli I Standardi III.4*).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- godina të bëhet e sigurt dhe miqësore për t'u përdorur nga studentë dhe vizitorë me aftësi të kufizuara, duke shtuar binarë udhëzues në hyrje të godinës dhe në shkallë, si dhe të ndërtohet një rampë në hyrje, brenda 12 muajve nga marrja e raportit përfundimtar (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.4**).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- ASAR-i duhet të përfundojë zhvillimin e një katalogu bibliotekar në linjë dhe të zbatojë marrëveshjen me McGraw-Hill për qasje në libra elektronikë (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**).

Gjykimi

Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

1. Statuti i ASAR-it
2. Rregullore e përgjithshme e ASAR
3. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore
4. Rregullore e Senatit Akademik
5. Rregullore e Këshillit të Etikës
6. Rregullore e Bachelorit për fizioterapi
7. Rregullore e Bachelorit për farmaci
8. Raport vjetor financiar, kërkimor dhe akademik i ASAR 2015-2016
9. Strategjia e Zhvillimit 2011-2015
10. Strategjia e Zhvillimit 2016-2021
11. Dokumenti i Informacionit të Përgjithshëm (DIP) (grup i të dhënave)
12. Lista e vendimeve të Senatit Akademik
13. Lista e vendimeve të Këshillit të Administrimit
14. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë a) niveli kombëtar,
15. b) niveli ndërkombëtar (shembull)
16. Lista e aktiviteteve ndërkombëtare ku institucioni është përfshirë
17. Marrëveshje bashkëpunimi për lëvizshmërinë e studentëve dhe stafit (shembull)
18. Procedurat për punësim në ASAR
19. Lista e aktiviteteve të studentëve (akademike dhe kulturore)
20. Lista e seminareve që mbështesin punësimin dhe aftësitë e studentëve
21. Lista e tezave të diplomës për Masterin në stomatologji
22. Broshura e praktikës së punës e Bachelorit për Fizioterapi
23. Broshura e praktikës së punës e Masterit për Stomatologji
24. Plani kalendarik i vitit akademik 2016-2017
25. Kurrikula e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (Master në Farmaci dhe Bachelor në Fizioterapi)
26. Kurrikula e Fakultetit të Ekonomisë (Bachelor në Menaxhim)
27. Të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me të diplomuarit
28. Rregullore për provimet në ASAR
29. Rregullore e Sekretarisë së ASAR
30. Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës
31. Procedurat e transferimit të studentëve
32. Modeli i kontratës së punës (me kohë të plotë dhe të pjesshme)
33. Praktika e hartimit dhe miratimit të kriterëve për pranimin në ASAR
34. Rregullore e arkivit të ASAR
35. Modeli i menaxhimit të provimeve përfundimtare dhe semestrale
36. Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
37. Pyetësorë të studentëve: shembull
38. Certifikata e mbrojtjes nga zjarri
39. Certifikata e higjienës sanitare
40. Certifikata e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të ASAR
41. Lista e auditëve të ASAR
42. Organigrama e ASAR
43. Broshurë informative
44. Projektraporti i akreditimit institucional (print)
45. Akreditimi institucional dhe programor
46. Printimi i faqes në internet të ASAR
47. Printimi i faqes në Facebook të ASAR
48. Printim që tregon komunikimet e brendshme

49. Lidhje në rrjetin me portalin e stafit akademik
50. Printimi i të faqes në internet të APAAL
51. Printim i faqes në internet që tregon njoftimet për studentët dhe publikun
52. Urdhri i Senatit Akademik për miratimin e Statutit të ASAR
53. Urdhri i Senatit Akademik për miratimin e Statutit të ri
54. Vendime të Këshillit të Etikës
55. Shembull i procesit të vendimmarrjes institucionale
56. Shembull i procesverbalit të mbledhje së Bordit / Këshillit të Administrimit
57. Raporti i NjSBC-së 2015-2016
58. Plani i Veprimit për përmirësim i nxjerrë nga analiza SWOT e NjSBC-së
59. Kërkim i tregut për Bachelorin në menaxhim
60. Konferenca e stomatologjisë në ASAR
61. Lista e bashkëpunimeve për praktikat e punës
62. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private
63. Lista e veprimtarisë ndërkombëtare të stafit akademik
64. Lista e stafit të huaj dhe të ftuar
65. Ngarkesa e stafit akademik për vitin 2016-2017 (model)
66. Vendimi i Këshillit të Administrimit ë lidhje me fondet për studentët
67. Agjenda e vizitave në shkolla të mesme për të informuar studentët e ardhshëm
68. Fondet për kërkimi 2016-2017
69. Lista e aktiviteteve sociale për stafin
70. Lista e artikujve shkencorë të stafit akademik
71. Modeli për vlerësimin e stafit nga ana e shefit të departamentit
72. Paneli vlerësues për rekrutimin e stafit të ri akademik
73. Kërkesa e departamentit për rekrutimin e stafit të ri
74. Hartimi dhe miratimi i projektbuxhetit
75. Lista e metodave të mësimdhënies
76. Lista e pasurive të luajtshme të ASAR
77. Të dhënat e matrikullit, model
78. Zbatimi i ngarkesës vjetore të mësimdhënies së stafit
79. Kërkesa për anëtarësim në Shoqatën Evropiane të Fakulteteve të Farmacisë (EAPF)
80. Studim i turizmit në rajonin e jugut
81. Plani i veprimit i NjSBC-së
82. Artikuj shkencor të botuar nga stafi
83. Lista e aktiviteteve të promovuara nga stafi
84. Vendim i Qeverisë nr. 650, datë 14.06.2011 dhe leja e MASH-it nr. 564, datë 22.11.2011
85. Letër shoqëruese dhe printim i statutit të ri
86. Rregullore e Qendrës Kërkimore Shkencore
87. Lista e udhëzimeve (tutorial)
88. Shembull i mbështetjes financiare për aktivitetin e studentëve
89. Mbështetje financiare për veprimtarinë shkencore të stafit, shembull
90. Shembull i shpërndarjes së fondeve shtesë për blerjen e 4 kokë manekin nga buxheti i vitit 2016
91. Grupi i punës për hartimin e buxhetit
92. Raporti vjetor financiar 2016
93. Lista e stafit që ka aplikuar për studimin e ciklit të tretë
94. Printimi i të faqes në internet të MAS-it
95. Printimi i të faqes në internet të RASH-it
96. Printimi i të faqes në internet të Ualbania
97. Titulli i pronësisë së pronës
98. Rregullorja e Tutorëve

99.	Shembull i mbështetjes financiare për veprimtarinë e lirë të stafit
100.	Shkolla verore e organizuar nga ASAR
101.	Lista e konferencave në ASAR

Mbledhjet

M1	Mbledhja 1 me Zëvendësrektorin
M2	Mbledhja 2, stafi i lartë drejtues
M3	Mbledhja 3, studentë të ciklit të parë
M4	Mbledhja 4, studentë të ciklit të dytë
M5	Mbledhja 5, partnerë dhe punëdhënës
M6	Mbledhja 6, stafi akademik
M7	Mbledhja 7, personeli mbështetës
M8	Mbledhja 8, Zëvendësrektori